

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7760 E shtunë 12 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Dje**  
në "Deutsche Welle"  
Një krizë e shpallur publike mes institucionit të Presidencës dhe Kryeministrit rrezikon të thellohet. Shkaku që del në sipërfaqe është refuzimi i presidentit...  
Vijon në faqen 21

**Nga ANI RUCI**  
**Meta-Bushati kundër ndryshimit të kufijve**  


**Opinion**  
Ditës  
Kryeministri Edi Rama caktoi për ministër të Jashtëm një djalë të ri të moshës 28-vjeçare dhe nga Prishtina, pas shtatë muajsh angazhimi në ministrinë e Jashtme...  
Vijon në faqen 20

**Nga ZEF MAZI**  
**Jepini fund këtij turpi!**  




BLUETOOTH/ "Sekreti" i Samanta Karavellës

## E vërteta e lidhjes së Florit me Kejsi Tolën, romanca nisi gjatë verës së shkuar

Me shaka apo jo, Fero dhe Arbenita pranojnë marrëdhënien. Xhani Shqerra, jeta përtej ekranit

Nga PAMELA ALIAJ

Fero me Arbenitën, Alba me Albin. Luana me Krenarin, e shumë e shumë çiftet t'jera po na e 'plasnin' shpirtin duke mos pranuar lidhjet e tyre. Pikërisht si kënga e tij, e cila rrëmbeu edhe kupën në "Kënga Magjike 2018"...

Suplement

## KRYEMINISTRI "SHPERTHEN" NDAJ PRESIDENTIT: ÇIZME REZERVE E OPOZITES

# RAMA: KRIM NDAJ ÇAKAJT. META: S'PRANOJ SHANTAZH

Presidenti kërkon hetim për DSIK: Pajisi brenda ditës Gent Cakajn me certifikatë sigurie. Basha dhe Kryemadhi, kundër Ramës: Kandidati cenoi sigurinë e NATO-s



(Në foto) Kryeministri Edi Rama, dje në emisionin "Zonë e Lirë"

Në faqet 2-3

### HETIMET



**Dokumenti i prokurorisë: U dëmtuan provat për grupin 'Bajri'**  
Në faqen 6

Studentët e universitetit i bashkohen nismës së Kryqit të Kuq shqiptar, 16 vite bashkëpunim

## "Luarasi", fushatë për dhurimin e gjakut

Et'hem Ruka: Të kontribuojmë të gjithë. Pedagogu: Akt humanitar

Nga VOLTIZA DURO

E dhe këtë vit, studentët e Universitetit "Luarasi" janë solidarizuar dhe i janë bashkuar nismës së dhurimit të gjakut, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar. Që prej themelimit në vitin 2003, ky institucion i arsimit



të lartë ka treguar një sensibilizim maksimal për t'u ardhur në ndihmë personave që kanë nevojë për gjak. Prej dy ditësh, holl i "Luarasi" është shndërruar në një qendër dhurimi gjaku, ku të rinjtë kanë shfaqur interes të lartë për të dhënë...

Në faqen 9

**AKUZAT**  
**Unaza, dyshime mbi tenderin e ri, kriteret kanë paracaktuar fituesin**  
Në faqen 6

**PASHALIMAN**  
**Grabitet depoja e armëve në bazën ushtarake, procedohen pesë ushtarakë**  
Në faqen 7

**PROTESTA**  
**Ngujimi në fakultete, policia ushtron dhunë ndaj studentëve të Ekonomikut**  
Në faqen 8

**SPARTAK NGJELA**  
**Romani "Hakmarrja e një gruaje", përdhunimi i femrave në komunizëm**  
Në faqen 10-11

## KONFLIKTI AKUZAT

Kreu i qeverisë akuzoi presidentin se është bërë çizme rezervë e opozitës

# Rama: Meta inkursion antikushtetues, sulmi ndaj Cakajit është kriminal

"Meta e ka marrë certifikatën e sigurisë për pak orë"

Kryeministri Edi Rama ka qenë mbrëmë më i shpër se kurë më parë, të paktën që nga 2013-ta, kur vendosën të bashkëpunojnë së bashku, kundër Presidentit të Republikës, Ilir Meta. I ftuar në emisionin "Zonë e Lirë", kreu i qeverisë nuk e kurseu fjalorin e tij ndaj Metës, të cilin e akuzoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në rastin e mosdekremit të Genti Cakajit, jo vetëm ka shkelur rëndë Kushtetutën, por edhe është përfshirë në një krim kundër tij. Kjo sipas Ramës, me të vetmin qëllim për ta përdorur Gent Cakajin si "mish për top" për të goditur Presidentin e Kosovës dhe Kryeministrin e Shqipërisë. "Ilir Meta ka marrë një inkursion antikushtetues të përsëritur. Është angazhuar në një krim ndaj diturisë, në një krim ndaj pastërtisë, në një krim ndaj një djali që nuk mundet dot që të meritojë njolllosjen e qëllimshme që Ilir Meta dhe jo vetëm Ilir Meta tentojnë t'i bëjnë për ta përdorur si mish për top kundër Presidentit të Kosovës dhe Kryeministrin të Shqipërisë", - tha kryeministri Edi Rama. Më tej, ai shtoi se po përdor në mënyrë abuzive postin e Presidentit, duke u kthyer në shërbim të opozitës. "Unë jam i shqetësuar për faktin që Presidenti i Republikës ka përdorur në mënyrë abuzive zyrën e tij për të goditur qeverinë dhe për t'i hedhur benzinë një zjari, që po tenton të ndizet në Shqipëri dhe në Kosovë si pjesë e një konspiracioni. Kjo është një masakradë, një përpjekje për të kriminalizuar një djalë të pastër, një djalë evropian. Këta janë të çmendur", - u shpreh Rama. Kryeministri e ka quajtur gjithë këtë debat një gjyq të pamerituar për një djalë të ri, ndërsa e krahasoi këtë fushatë me gjyqet e kohës së komunizmit. "Një gjyq publik stalinist, që e organizon Presidenti i Republikës. Si mundet Presidenti i Republikës të shkruajë që ky ka mendime që bien ndesh me politikën e jashtme të Shqipërisë. Këto janë si gjyqet staliniste. Kemi sot një zyrë Presidenciale, që është jashtë kontrollit dhe që organizon gjithë këtë fushatë", - tha më tej Rama. Duke u ndalur të çështja e certifikatës së sigurisë, Rama solli në vëmendje të Metës se nuk ka ndjekur këtë standard me ministrat e tjerë më parë. Ai solli në vëmendje rastin e Olta Xhaçkës, e cila kur është dekretoar nga Meta, nuk



Kryeministri Edi Rama, dhe në emisionin "Zonë e Lirë"

### SKADON AFATI KUSHTETUES, META NUK VENDOS PËR BUSHATIN

Presidenti i Republikës nuk ka dhënë as dje brenda afateve kohore që përcakton Kushtetuta, një përgjigje në lidhje me propozimin e kryeministrit Edi Rama për shkarkimin e ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati. Në bazë të Kushtetutës, presidenti ka 7 ditë kohë për të dekretoar një propozim emërimi apo shkarkimi të një ministri. Por ndër- sa për të gjitha propozimet e tjera të bëra nga Rama të premtën e shkuar, për propozimin e shkarkimit të Ditmir Bushatit, Meta nuk mori të paktën deri mbrëmë në skadim të afatit kushtetues një vendim. Sipas "Zërit të Amerikës", Meta nuk e ka marrë këtë vendim për të mos i dhënë mundësi Ramës që të drejtojë Ministrinë e Jashtme me anë të zëvendësministrit Genti Cakaj, që ai e refuzoi si ministër.

e ka pasur certifikatën e sigurisë. Jo vetëm kaq, por Rama bëri të ditur se edhe vetë Meta e ka marrë certifikatën e sigurisë brenda pak orësh. "Në vitin 2016 Ilir Meta si kryetar i Kuvendit e ka marrë certifikatën e sigurisë brenda më pak se 24 orëve", theksoi Rama. Ai shtoi se ky nuk është rasti i vetëm që kreu i shtetit ka shkelur Kushtetutën. Rama ka rënditur se më parë ai ka shkelur Kushtetutën në rastin e Lleshajt, por edhe në rastin e kthimit të disa ligjeve financiare. "Ilir

Meta në mënyrë të përsëritur po sfidon Kushtetutën. Ilir Meta ka vendosur që duke qenë në një tren papërgjegjshmërie, po i thotë Kushtetutës jam unë, pa je ti. Ilir Meta ka shkelur Kushtetutën në mënyrë të përsëritur, ka shkelur Kushtetutën me Sandër Lleshajn, ka shkelur Kushtetutën në kthimin e shumë ligjeve që s'ka tagër fare t'i kthejë. Ai e ka humbur betejën e tij politike dhe është aty të garantojë pavarësinë e institucioneve dhe mendimet e Ilir Metës për taksat nuk më

interesojnë fare. Mendimet e veta t'i mbajë për vete, çështja e taksave është çështje e votës së popullit. Bujar Nishani nuk arriti dot aty ku ka arritur dhe është zhytur Ilir Meta", shtoi Rama. Por pavarësisht gjithë këtyre shkeljeve, kreu i qeverisë tha se nuk do të shkente drejt shkarkimit të Ilir Metës, pasi nuk kishte votat e duhura në parlament. "Shkarkimi i Presidentit kërkohet 2/3 e votave të Kuvendit të Shqipërisë. Dhe kjo është logjika që përdor Ilir Meta në këtë rast që mua s'kanë votat. Dakord le ta bëjë, por e bën për turpin e tij dhe sillet sikur të ishte kryetar i LSI-së në ditët e veta më të këqija. Në goftë se Ilir Meta tenton të drejtojë opozitën, apo ka vendosur ta kthejë Presidencën në një çizme rezervë të kësaj opozite, ai le ta bëjë. Por unë dua t'u them sot shqiptarëve që nuk do të hyj në një konflikt institucioneve", - deklaroi Rama, ndërsa bëri të ditur se mazhoranca do të presë krijimin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur fatin e Metës. Sa i përket diskutimit se Genti Cakaj është një djalë i ri, Rama tha se Shqipëria ka pasur kryeministra në moshën e tij, përfshi këtu edhe Ilir Metën dhe Pandel Majkon. "Ilir Meta është objekt humorit se s'ka çfarë t'i bëjë fare kësaj qeverie, as ta pengojë e Ilir Meta dhe as zuzarët e tij", - u shpreh kryeministri.




Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

#### PËR METËN

"Mos e merrni seriozisht ju lutem, ose i ka vjedhur doktoresha e shkencave 'password'-in e faqes zyrtare, ose pastaj është në atë fazën kur i bën thirrje popullit për të marrë armët, ngaqë s'di si të dalë nga gropa që i hap vetes! I çova provat e mëkatit ndaj Gentit dhe vuan tani".

#### PËR ANALISTËT

"Janë shpërndarë kadrinjtë krka-krka-krka, nga Andi Kadriu tek Kadri Lubonja e më radhë Kadri andej e Kadri këtej, futur shtëpi më shtëpi nga vrima e televizorit, duke u rrekur t'i tërheqin njerëzit pas gurit që hodhi në lumë IM".



### Kryemadhi: Rama, përdorues i certifikuar i substancave sintetike

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim u ësh të përgjigjur dje me të njëjtën mënyrë deklarave të kryeministrit Edi Rama, ku i fundit e ka konsideruar si "doktoreshë". Gjatë një konference për mediat nga selia e LSI-së, Kryemadhi ka theksuar se grupe të ndryshme shoqërore, siç janë studentët, pedagogët e përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë gjenden sot përballë sjelljes jo normale të kryeministrit Rama. "Pedagogët janë përballë një të sëmurit, kriminelit që pasi shkatërroi institucionet, policinë, gjykatat e prokurorit për të fshehur krerët e policive që kanabizuan vendim, duhet të kuptojnë se shumë shpejt do të shkatërrojë edhe universitetin", - tha Kryemadhi. Ajo e akuzoi Ramën si një përdorues i rregullit i drogave të ndryshme dhe sjelljen e tij, produkt të efektit të tyre. "Përdorues i certifikuar i produkteve, nga faza organike në fazën e substancave sintetike është në situatë shumë të rëndë psikike dhe klinike. E them si doktoreshë që jam, por nëse nuk më beson mua, të pyesë pedagogët që i ka anëtarë të PS. Kryeministri ynë është në efektin për gjithë jetën ndaj këtyre izotopeve, thirrje mjekëve që janë të PS dhe deputetëve mjekë në grupin e PS të marrin fatet në dorë, se jo vetëm fatet e vendit, por edhe të fëmijëve të tyre janë në dorë të një të sëmurit psikik. Peng i kimit të organizuar është edhe peng i substancave sintetike", u shpreh Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së sulmoi edhe DSKI-në se "është kthyer në një dyqan gjobash dhe në një institucion falsifikues të certifikatave të sigurisë".





Presidenti kërkon hetim për DSIK: Pajisi Cakajn me certifikatë sigurie brenda ditës

# "Cakaj", Meta: S'ka fuqi në botë që të shantazhojë presidentin

"Rama bëri gabim fatal, kërcënoi edhe presidentin"

Valentina Madani

Mosdekretimi i kandidatit për ministër të jashtëm Gent Cakaj evidentoi një tjetër përplasje mes kryeministrit Edi Rama dhe Presidentit Ilir Meta. Dy ditë më parë kryeministri Rama e cilësoi si antikushtetues dhe të turpshëm, mosdekretimin e kandidatit të Cakajit. Por kreu i shtetit Ilir Meta iu kundërpërgjigj Ramës me tone të forta nëpërmjet një postimi në Facebook, duke i thënë se nuk ka fuqi në botë t'i bëjë presion e shantazh Presidentit të Republikës së Shqipërisë. "Ai që guxoi të kërcënojë komisar Zaganin pse denoncoi bashkëpunimin e trafikantëve të drogës me pushtetarët, ai që guxoi të kërcënojë nënkomisarin e Fushë-Krujës pse hetoi dhunimin e një vajze nga djali i një deputeti, ai që guxoi të kërcënojë një profesor të ndëruar vetëm pse i shkruajti një letër Presidentit të Republikës në mbrojtje të interesit kombëtar, ai që kërcënon çdo ditë gazetarë e pronarë mediash, ai që kërcënon prokurorë e gjyqtarë, ai që kërcënon opozitarë dhe dëshmitarë, ai që urdhëron falsifikimin e letrave të tenderëve e deri tek dokumente të sigurisë kombëtare bëri gabimin fatal të kërcënojë edhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Nuk ka fuqi në botë t'i bëjë presion e shantazh Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Nuk ka Gjykatë Kushtetuese në botë që ndalon e interpreton kompetencat që i jep Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Presidentit, për emërimin e shkarkimin e ministrave e në veçanti të atyre që janë anëtarë të Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Interesi kombëtar i pari! Shqipëria e Para!", shprehet Presidenti Ilir Meta.



**DEKLARATA**  
"Nuk ka fuqi në botë t'i bëjë presion e shantazh Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Nuk ka Gjykatë Kushtetuese në botë që ndalon e interpreton kompetencat që i jep Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, presidentit, për emërimin e shkarkimin e ministrave e në veçanti të atyre që janë anëtarë të Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Interesi kombëtar i pari! Shqipëria e para!"

## SHKELJA

Z. Meta shprehet në letërën e tij se Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka anashkaluar verifikimin e të dhënave kur Cakaj ka qenë në Hungari dhe Belgjikë dhe se hetimi sipas tij për këtë çështje nuk mund të kryhet nga institucione në varësi të kryeministrit.

## "Cakaj", opozita dorëzon në Kuvend kërkesën për komisionin hetimor

Opozita dorëzoi dje në Kuvend kërkesën për ngritjen e një komisioni hetimor që do të verifikojë nëse DSIK e ka zbatuar ligjin për pajisjen e zëvendësministrit të jashtëm Gent Cakaj me certifikatë sigurie dhe si është zbatuar ligji për administrimin dhe përpunimin e informacioneve pa qenë i pajisur me parë me këtë dokument. Në kërkesën e opozitës janë 4 çështje që janë objekt i hetimit parlamentar, i cili u paralajmërua një ditë më parë nga kreu i opozitës Lulzim Basha, gjatë emisionit "Opinion". Bie në sy se një nga personat që do të hetohet nga parlamenti është kryeministri Edi Rama për rolin e tij në shkeljen e rregullave për garantimin e sekretit shtetëror: 4 çështjet objekt i komisionit hetimor të kërkuar nga opozita janë: Verifikimi i ligjshmërisë dhe efekteve të veprimeve të institucioneve shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me "certifikatë sigurie" nga DSIK; Roli i Këshillit të Ministrave, Kryeministrit apo ministrave përgjegjës në shkeljen e procedurave dhe rregullave për garantimin e informacionit "sekret shtetëror" dhe shkeljen e procedurave për pajisjen e z. Cakaj me "certifikatë sigurie"; Arsyet e moszbatimit të ligjit nga z. Gent Cakaj për mbi 7 muaj dhe pasojat që ka sjellë për sigurinë kombëtare dhe angazhimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat për në BE; Autoritetet përgjegjëse që kanë lejuar z. Cakaj, të administrojë dhe përpunojë informacion të klasifikuar, pa qenë më parë i pajisur me "certifikatë sigurie".



## KËRKESA

Opozita kërkon që komisioni të ketë 9 anëtarë, ku kryetari të jetë nga PD, si dhe një afat kohor prej 3 muajsh. Sipas rregullores, Konferenca e Kryetarëve duhet të mbledhet jo më vonë se 5 ditë nga dorëzimi i kërkesës për të diskutuar kërkesën, përbërjen e komisionit, si dhe caktimin e datës së miratimit në Kuvend në seancën plenare më të afërt.

## HETIMI

Përsheptimi i procedurave për dhënien e certifikatës së sigurisë për Gent Cakajin i kanë dhënë mundësi Presidentit të Republikës që të ndër marrë një tjetër nisim. Përmes një shkresë dërguar Kryetarit të Kuvendit dhe përfaqësuesve të Grupëve Parlamentare, Ilir Meta kërkon ngritjen e një Komisioni Parlamentar Hetimor

## DSIK i përgjigjet Metës: Cakaj u verifikua në përputhje me ligjin

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar njoftoi dje se Gent Cakaj është pajisur me certifikatë sigurie në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi. "Verifikimi i sigurisë për Gent Cakaj është kryer i plotë, me përparësi dhe në përputhje me detyrimet ligjore DSIK administron përgjigjet zyrtare të Autoriteteve Verifikuese brenda vendit; SHISH, SHÇBA, si dhe të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), si i vetmi Autoritet Verifikues i Republikës Kosovës, pasi Cakaj mban edhe shtetësinë e Kosovës, krahas shtetësisë shqiptare", thuhet në njoftimin e DSIK. Sipas DSIK, referuar përgjigjeve të Autoriteteve Verifikuese ka rezultuar se për Gent Cakajin nuk ekziston rrezik i papranueshëm sigurie për pajisjen e tij me CSP sipas kërkesës së paraqitur nga MEPJ. DSIK bën të ditur se edhe procedurat e verifikimit të sigurisë janë ndjekur me angazhim maksimal brenda afateve kohore të parashikuara.



"Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit dhe lëshimit të CSP-së nga DSIK-ja është deri në 120 ditë kalendarike. Brenda kësaj periudhe përfshihen edhe afatet e verifikimit të sigurisë nga ana e autoriteteve verifikuese. Autoriteti verifikues dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që merr kërkesën e paraqitur nga DSIK për të kryer verifikimin e sigurisë, ka detyrimin të kryejë procedurat dhe të kthejë përgjigje duke dhënë informacionin e kërkuar me shkrim, jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës".

për Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, që është në varësi të Kryeministrit. Pas refuzimit, Presidenti Ilir Meta kërkon t'i shkojë deri në fund dyshimit të tij se Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka shkelur ligjin në rastin e kandidatit për Ministër të Jashtëm Gent Cakaj. "Referuar fakteve, dhe të dhënave të Gent Cakaj, konstatohet

qartë se nuk është kryer një proces i mirëfillt verifikimi sipas kushteve, detyrimeve, kritereve dhe procedurës së parashikuar në Rregulloren e Sigurimit të Përgjithshëm. Duke qenë se nga ky proces shqyrtues i Presidentit të Republikës, janë evidentuar shkelje të rënda në veprimtarinë e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Presidenti i Re-

publikës, vlerëson të domosdoshme kryerjen e një hetimi të plotë administrativ mbi veprimtarinë e këtij institucioni mbi këtë rast", shprehet kreu i shtetit. Nëpërmjet letërës, kreu i shtetit i kërkon Kryetarit të Kuvendit dhe kreut të grupeve parlamentare të nisin një hetim administrativ për të parë sesi brenda një dite, DSIK ka kryer të gjitha verifikimet për Gent Cakajin dhe e ka pajisur me të gjitha certifikatat e sigurisë. Këtë fakt, Presidenti e mbështet në korrrespondencat që ka patur me Ministrinë e Jashtme dhe me vetë Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar. "MEPJ konfirmon se ky institucion e ka përcjellë menjëherë më 03.01.2019 dosjen e Gent Cakajit pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe kjo e fundit, e ka pajisur atë me certifikatat përkatëse të sigurisë 1 (një ditë) më pas më datë 04.01.2019. Në formën si është kryer procesi i verifikimit të sigurisë për z. Gent Cakaj, ai nuk garanton besueshmërinë e duhur të Certifikatave të Sigurisë të lëshuara nga Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar", thuhet në letër. Një proces verifikimi brenda 24 orëve për Presidentin krijon dyshime të rënda për veprimtarinë aspak objektive të DSIK, sidomos kur verifikimi duhet të shtrihet edhe në organizatat partnere të Kosovës. Prandaj thirrja e Metës shkon edhe për secilin deputet të Kuvendit që të ngrihet një komision hetimor dhe të hetohet ky proces.

# KRIZA E DEKRETIT REAGIME

Ambasadorët i kërkojnë kryeministrit që të propozojë një kandidaturë tjetër

## Këshilli i Ambasadorëve, kundër Ramës: Cakaj ska cilësitë e duhura

"Ky lloj kontestimi, i pashembullt në 29 vjet"

Pjesë e debatit për emrin e ri të ministrit të Jashtëm janë bërë edhe ambasadorët. Nëpërmjet një deklarate të përbashkët, Këshilli i Ambasadorëve shpreh shqetësimin e tij për cilësitë jo të duhura që përfaqëson kandidatura e Gent Cakajt për të qenë në një detyrë të rëndësishme si ajo e ministrit të Jashtëm. Sipas ambasadorëve, kandidatura e përzgjedhur nga Rama për të emëruar ministër të Jashtëm Cakaj ka ngjallur një shqetësim të madh në një pjesë të gjerë të opinionit publik, përfshirë edhe shumicën e anëtarëve të këtij këshilli. Sipas tyre, ky kontestim nuk është hasur asnjëherë përgjatë këtyre 29 vjetëve demokraci për çdo ministër tjetër të emëruar në këtë post. "Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë vëren se kandidatura e përzgjedhur nga kryeministri Rama për të emëruar ministër për Europën dhe Punët e Jashtme. Zoti Gent Cakaj ka ngjallur një shqetësim të madh në një pjesë të gjerë të opinionit publik, përfshirë edhe shumicën e anëtarëve të këtij këshilli. Ky lloj kontestimi, i pashembullt për asnjë nga ministrat e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë gjatë këtyre 29 vjetëve demokraci, mbështetet në perceptimin publik të personalitetit të zotit Cakaj si pacilësi dhe nevojshme profesionale për të mbajtur barrën e një detyre të tillë më rëndësi kombëtare", - thuhet në deklaratën e Këshillit të Ambasadorëve. Ndaj nisur pikërisht nga ky perceptim dhe shqetësim që ka ngjallur emri i Cakajt, ky këshill i sugjeron kryeministrit Rama që të propozojë një emër tjetër të denjë për një pozicion kaq të rëndësishëm, sidomos për një periudhë ku Shqipëria në presin vendime të rëndësishme, siç është edhe ai për çeljen e negociatave me BE-në. "Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë i tërheq vëmendjen kryeministrit Rama ta rivlerësojë kandidaturën e ministrit në fjalë, duke mbajtur më mirë parasysh interesin publik dhe kombëtar", - thuhet më tej në këtë deklaratë. Nga ana tjetër, ata e



Këshilli i Ambasadorëve

**PËR BUSHATIN**  
"Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë tërheq vëmendjen me shqetësim të fakti se kryeministri nuk ka kryer detyrimin e tij kushtetues për të bërë transparencën mbi arsyet që e kanë shtyrë atë të shkarkojë posaçërisht ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme".

### Noka: E pamundur që DSIK të kryejë verifikimin për 24 orë për Cakajin


Nënkryetari i Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare, Flamur Noka ka akuzuar Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) se ka shkelur ligjin duke u bërë një vegël politike në duart e Ramës, duke i dhënë një certifikatë të sigurie Genti Cakajt pas një verifikimi krejt formal. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Noka shprehet se nuk ka asnjë mundësi reale që një person të verifikohet për 24 orë në dy shtete. "DSIK pranoi vetë e zeza mbi të bardhë se është në shkelje të ligjit dhe një vegël politike në duart e Edi Ramës. Drejtoria e Sigurisë për Informacionin e Klasifikuar pranoi që me të preferuarin e Edi Ramës bëri atë që nuk e ka bërë për asnjë zyrtar që duhet të pajiset me certifikatë sigurie: e verifikoi brenda 24 orëve. Nuk ka asnjë mundësi reale që një per-



son të verifikohet për 24 orë në dy shtete. Shkelja e ligjit është e padiskutueshme në të gjithë procedurën e ndjekur nga DSIK me urdhrin e Edi Ramës", - shkroi Noka. Sipas tij, rasti 'Cakaj' tregoi se Edi Rama e ka shndërruar DSIK në një "kioskë dizinformuese dhe lavatër të punëve të pista të qeverisë, duke rrënuar seriozitetin e shtetit shqiptar në sytë e partnerëve ndërkombëtar", - shtoi Noka në reagimin e tij. Deputeti demokrat akuzoi kryeminis-

trin se me veprimet e tij po e nxjerr Shqipërinë një shtet jo serioz në sytë e aleatëve dhe partnerëve ndërkombëtarë. "Në vend që partnerët të na shohin si një shtet serioz, Edi Rama u tregon atyre se sekretit shtetëror i një vendi të NATO-s administrohet në mënyrë banditeske për interesa thellësisht personale dhe shpeshherë, kundër interesit kombëtar", - shkroi Noka në deklaratën e tij.

shqiptar në këtë periudhë", - thuhet në deklaratën e Këshillit të Ambasadorëve. Ata evidentojnë se viti 2019 do të jetë veçanërisht i ngarkuar me sfida për diplomacinë tonë dhe në përgjithësi për politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë. Me kryesoret e kë-



Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me ministrat

**Spartak Ngjela:**  
Rama zgjodhi për ministër të Jashtëm një kalama

Kundër propozimit të Edi Ramës për të emëruar Gent Cakajin si ministër të Jashtëm ka dalë edhe avokati Spartak Ngjela. Ai ka sulmuar ashpër kryeministrin Edi Rama si dhe presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ndërsa i akuzon ata se Mitrovicën do t'ia japin Serbisë. Sipas Ngjelës, Rama "i shtet njëllë, si bashkëpunëtorë në korrupsionin qeveritar, edhe interesin kombëtar", ndërsa shton se ai nuk i shpëton dot reformës në drejtësi. Teksa ndalet tek debati i madh që ka pshuar politikën pas vendimit të Metës për të mos dekretuar si ministër të Jashtëm Gent Cakajin nga Kosova, Ngjela thekson se Rama zgjodhi një kalama. "Rama në fakt është krejt jashtë çdo koncepti drejtimi për një shtet. Zgjedh një kalama ministër të jashtëm dhe mendon se me kombësinë e tij do të mund ta paraqesë marrëzinë Rama si "mendim racional për të drejtuar Europën", shkruan Ngjela.

**Pagëzohet Maqedonia e Veriut, shqiptarët votojnë 'pro'**

Kuvendi i Maqedonisë me 81 vota "pro", miratoi dhe ndryshimin e Kushtetutës për zbatimin e marrëveshjes me Greqinë për zgjidhjen e kontestit 27-veçar të emrit. Ndryshimet kushtetuese janë miratuar pas negociatave të gjata me opozitën shqiptare, lidhur me disa amendamente të saj për pozitën e shqiptarëve në Kushtetutë. Tirana zyrtare e përsëriti votimin e ndryshimeve kushtetuese, që i japin zyrtarisht emrin Maqedonia Veriore. Ministri në detyrë i Jashtëm, Ditmir Bushati shprehet: "Vota finale e marrëveshjes së Prespës në Parlamentin e Maqedonisë është demonstrim i qartë i aftësisë politike për të zhblokuar rrugën drejt NATO-s dhe BE. Kontributi i faktorit politik shqiptar provoi sërish që është faktor vendimtar. Urime!" shkruan Bushati. Ky votim u përsëritet edhe nga kreu i PD, Lulzim Basha. "Ky akt i përgjegjshmërisë së lartë politike është një hap historik për konsolidimin e rajonit si pjesë e familjes Euroatlantike që forcon paqen, sigurinë dhe vlerat demokratike", shprehet Basha.

sive, nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës së përshatshme për marrjen e presidencës së OKB-së në vitin 2020, ndërtimi i një mirëbesimi të gjerë ndërkombëtar për të fituar të drejtën e anëtarit të përkohshëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për vitin 2022.

tyre sfida janë marrja e vendimit për çeljen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian nga ana e Këshillit Europian në fund të pranverës së ardhshme, përfundimi i shtyrë teçdo parashikimi i marrëveshjes për kufirin detar me Greqinë, përgatitje inten-





Kreu i PD-së kërkon hetim nga Kuvendi për DSIK, Ramën, Bushatin, Cakajn dhe SHISH

# Rasti "Cakaj", Basha: U cenua siguria kombëtare dhe e NATO-s

"Skandali, po hetojmë mënyrat e përfshirjes"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, apeloj dje për hetimin e paligjshmërisë me DSIK, në rastin e zëvendësministrit të Jashtëm, Genti Cakaj. Pas kërkesës së Presidentit Ilir Meta për hetim parlamentar të DSIK, kreu i PD-së njoftoi se opozita ka nisur punën për të hetuar të gjithë mënyrat si është dhënë certifikata e sigurisë për Gent Cakaj. "Hetim parlamentar për DSIK, kryeministrin Rama, Ditmir Bushatin, Gent Cakajn dhe SHISH për dhunimin e ligjit që cenon sigurinë e vendit", theksoi z.Basha. Paralelisht me kreun e shtetit edhe opozita kërkon ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe çështjen e ministrit të Jashtëm të propozuar, Gent Cakaj. Pak minuta pasi presidenti publikoi kërkesën për hetim, kryetari i PD, Basha deklaroi se opozita insiston në zbardhjen e plotë të kësaj çështjeje. I pyetur lidhur me kërkesën e Presidentit Meta për hetimin e DSIK, Basha deklaroi: "Nuk jam në dijeni të kërkesës së presidentit, por që prej publikimit të dekretit të presidentit, ashtu siç bëra publike dhe në emisionin 'Opinion', kemi nisur punën për të hetuar në të gjitha format e mënyrat duke përfshirë dhe hetimin parlamentar, përgjegjësitë e DSIK-së, z.vministrit Cakaj, ministrit Bushati, kryeministrin Rama dhe Shërbimit Informativ të Shtetit në dhunimin e ligjit për informacionin e klasifikuar sekret në Republikën e Shqipërisë dhe pasojat që kjo ka për sigurinë kombëtare dhe sigurinë e NATO-s", tha z.Basha. Një gjë të tillë kreu i PD-së e paralajmëroi edhe dy ditë më parë në emisionin "Opinion". "Dhe pikërisht në këtë kohë, një nga hallkat, natyrisht jo më të forta të Aleancës, një vend i cili është përfolur për problematikë në mbrojtjen e sekretit shtetëror, propozon për ministër të Jashtëm, ministri më kryesor i NATO-s, sepse të mos harrojmë, NATO është një aleancë politiko-ushtarake, jo ushtarako-politike, një person i cili ka neg-



HETIMI

"Hetim parlamentar për DSIK, kryeministrin Rama, Ditmir Bushatin, Gent Cakajn dhe SHISH për dhunimin e ligjit që cenon sigurinë e informacionit sekret dhe që cenon sigurinë e vendit", theksoi z.Basha.

## Glos: Ndërhyrja në lirinë e medias cenon negociatat me BE

Në bashkëpunim me fondacionin "Konrad Adenauer Stiftung" (KAS), PD organizoi dje tryezën "Media e lirë, shoqëri e lirë - rreziku i heshtjes me ligj". I pranishëm në tryezë presidenti i Fondacionit KAS për Shqipërinë, Walter Glos u shpreh se ndërhyrja në lirinë e medias cenon vendimin për negociatat. "E di se disa media dhe përfaqësues të tyre kanë shprehur shqetësimin e tyre rreth këtyre dy projektligjeve. Ato paraqesin rrezikun e censurës dhe një kufizim të lirisë së medias. Nëse shteti merr kontrollin mbi median, në çfarëdolloj forme, është një pikëpyetje e madhe. Përfaqësues të organizatave ndërkombëtare e kanë bërë apel kryeministrin Rama t'i tërheqë këto projekte, çka do të thotë se diçka nuk shkon me projektligjet. Më duhet të kujtoj se është tentativa e dytë e Edi Ramës për të ndërhyrë në legjislacionin mbi median. Shqipëria si një vend kandidat për në BE ka detyrimin të respektojë lirinë e medias. Pa pasur këtë garanci të lirisë së shprehjes, nuk mund të funksionojë demokracia. Zhvillimi i medias nuk mund të nënvlefësohet zhvillimi i medias, në procesin e afrimit me BE. Dhe ndonjëherë më krijohet ideja se qeveria aktuale nuk e ka shumë vëmendjen tek rëndësia e kësaj pjese. Në Evropë është krijuar përshtypja se Shqipëria nuk i respekton rregullat dhe ligjet ndërkombëtare. Lista e shkeljeve në tenderat publike psh., është shumë e gjatë. Shqipëria dhe qeveria aktuale ka ende në dorë të bëjë gjithçka që në qershor të merret çelja e negociatave. Por, ndërhyrja në lirinë e medias padyshim që nuk e ndihmon në këtë proces", tha z. Glos.



DEKLARATA

"Shqipëria dhe qeveria aktuale ka ende në dorë të bëjë gjithçka që në qershor të merret çelja e negociatave. Por, ndërhyrja në lirinë e medias padyshim që nuk ndihmon në këtë proces", tha z. Glos.

## Gazetarët kundër "Antishpifjes": Do detyrohemi të dalim në protestë si studentët

Gazetarët profesionistë dhe deputetët e opozitës u shprehën dje kundër paketës "Antishpifje" të propozuar nga kryeministri Rama. Në një tryezë të organizuar nga Partia Demokratike për lirinë e medias, kreu i opozitës Lulzim Basha u shpreh se kreu i qeverisë, Rama, kërkon të censurojë fjalën e lirë me ligj. "Ajo që Edi Rama po propozon është Policia e Mendimit. Është padyshim një akt marrëzie i një njeriu të rrezikshëm. Për ne si opozitë, nuk ka rrugë tjetër përveç vetëregullimit", tha z.Basha. Drejtuesit e mediave dhe gazetarët, të cilët preken drejtpërdrejtë nga paketa "Antishpifje" ngritën alarmin për situatën totalitare në të cilën kërkon ta fusë qeveria median në Shqipëri. Gazetari Shkullaku tha: "Jemi një hap regjimeve totali-



tare, më mirë të kemi kaos, sesa një ligj dhe një regjim, që di të na mbyllë gojën të gjithëve. Çfarë duhet të bëjmë që ky njeri të ndalet? Të dalim edhe ne si studentët?". Kurse z.Ylli Rakipi u shpreh: "Tani ky del dhe kërkon të bëjë ekzibicion edhe në media". Organizatat e medias kërkuar që tregu

mediatik duhet të vetëregullohet dhe jo të vendosen penalizime pa vendim gjykatë. Ligji për "Antishpifjen", i përgatitur nga qeveria shqiptare po konsultohet me grupet e interesit dhe pritet që me nisjen e sesionit parlamentar të kalojë në Kuvend për t'u miratuar.

lizhuar për të paktën 6-7 muaj certifikatat e sigurisë. Ka qenë ky person këto kohë me informacion të klasifikuar? Këto janë pyetje që duhet të jenë subjekt i një inspektimi zyrtar, shtetëror nga institucionet përkatëse. Po ju them një gjë fare qartë: Këtu kemi të bëjmë me një shkelje flagrante të ligjit, si dhe të sig-

urisë kombëtare dhe të sigurisë së NATO-s", theksoi kreu i PD-së. Më herët edhe Presidenti Meta kërkoi ngritjen e Komisionit Hetimor parlamentar për hetimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara, DSIK mbi procesin e pajisjes me certifikatat e sigurisë për shtetasin Gent Cakaj, me

detyrë zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtëme. Kërkesa me nr protokoll 16/2 dhe datë 11 janar 2019, i është drejtuar kryetarit të parlamentit. Ky hetim nis pas zbulimit se Gent Cakaj i cili ka mbajtur postin e z.vministrit pa pasur një certifikatë sigurie për 7 muaj u pajis nga DSIK me certifikatë sigurie brenda një dite.

Operatorët e biznesit ankohen: Lihet hapësirë për një aferë korruptive

# Unaza, dyshime mbi tenderin e ri, kriteret kanë paracaktuar fituesin

## Kërkohet vinç mbi 450 tonë, por ai nuk gjendet

**P**as dështimit të kontratës mes bashkimit të kompanive 'Biba X' dhe 'DH Albania' për shkak të skandalit të falsifikimit të dokumenteve nga ana e firmës mëmë të 'DH Albania' 'Dunwell Haberman' Autoriteti Rrugor Shqiptar ka rihapur në 13 dhjetor garën për të njëjtin segment të Unazës së Madhe. Në shpalljen e parë njëسيا e prokurimit publik kishte vendosur kriteret ligjore që ishin hapazti në shkellje të ligjit.

Por ajo që bie në sy edhe në rihapjen e garës së dytë, kriteret e vendosura nga prokurimet duket se përcaktojnë që në fillim operatorin fitues dhe lënë hapësirë të rishitjes për afëra korruptive.

"News 24" ka zbuluar dokumentin ku shihet se një nga këto kriteret është kërkesa për kapacitete e mjetet dhe makinerive që operatorët duhet të disponojnë për të marr pjesë në këtë procedurë. Lidhur me këtë kërkesë rezultojnë se makineritë e kërkuara nuk janë në raport me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen.

Në pikën 13 për mjetet e punës kërkohet një autovinç me kapacitet mbi 450 tonë. Por sipas subjekteve që kërkohet të marrin pjesë në garë në preventivin e punimeve tek zëri i punës thuhet se nga ana teknike për të tërhequr trarë me gjatësi 34 metra linear që do të pendoren për projektin do të mjaftonte një autovinç me një kapacitet deri në 210



Faksimile e dokumenteve të prokurimit të objekteve

tonë. Këtu lindin edhe dyshimet e operatorëve për një garë sipas tyre jo transparente. Burime nga drejtorja e përgjithshme e transportit rrugor thonë për News24 se në vendin tonë një mjet i tonazhit me kapacitet 450 tonë nuk gjendet.

Sipas po të njëjtave burime mjeti më i rëndë që ka hyrë në doganat sh-

qiptare është vetëm 10 tonë, por që nuk dihet kapaciteti mbajtës i tij pasi dogana regjistron vetëm peshën e mjetit dhe jo kapacitetin. Ky kriter thotë operatorët jo vetëm vështirëson pjesëmarrjen në garë, por duket që në fillim se përcakton dhe fituesin e garës.

Kërkesa e prokurimeve për një mjet me kapacitet

450 tonë duket absurde pasi sipas ekspertëve tërheqja e trarëve prej 34 metra linearësh që do të përdoren për lotin e parë të unazës së madhe mund të realizohet edhe me një vinç me një kapacitet maksimum deri në 210 tonë. Atëherë lindin pyetjet se cila është arsyeja e kërkesës për vinça të tonazhit më të rëndë sesa nevo-

**FIRMA FANTAZME**  
Kompania amerikane "Dunwell Haberman" nuk ka fituar vetëm garën për ndërtimin e një pjese të Unazës së Re, për 18 milionë euro pa TVSH, por më 31 tetor 2018, është shpallur fituese dhe e një tanderi tjetër, për ndërtimin e një pjese të linjës 220 kv Burrel-Peshkopi, për një vlerë prej afro 11.7 milionë eurosh.

ja për realizimin e veprave të artit në lotin e parë të Unazës së Madhe nga pallati me shigjeta deri tek rrethrotullimi i sheshit 'Shqiponja'? Pse njëسيا e prokurimit vendos kriteret diskriminuese, të cilat dëmtojnë konkurrencën dhe pengojnë operatorët ekonomikë të interesuar të marrin pjesë në garë?



### Masakroi vajzën e tij, dhunohet barbarisht në burg Aleko Petro

**GREQI** - Është dhunuar në ambientet e qelisë Aleko Petro, i cili pak ditë më parë masakroi për vdekje me levë hekuri vajzën e tij 29-vjeçare, Angeljinën. Ngjarja ka ndodhur në burgun e Koridhalos, ku 52-vjeçari është dhunuar nga të burgosurit e tjerë. Lajmi është bërë i ditur nga Vasillis Noulezas, avokati i shqiptar, i cili ka deklaruar se pas kësaj ngjarjeje Aleko Petro është dërguar në spital për trajtim mjekësor. Sipas avokatit, 52-vjeçari është në gjendje të rënduar psikologjike. Sipas rrëfimit të Aleko Petros, disa të burgosur e kanë sulmuar dhe dhunuar egërsisht. Për këtë arsye ai ka kërkuar që të transferohet në burgun e Grevenas, pasi ka frikë për jetën e tij. Aleko Petro ndodhet nën masafë e sigurisë burg pa asnjë pasiguri për dënimin që dhunoi për vdekje të bijën, Angeljina Petro, pasi nuk pranonte lidhjen e saj me një emigrant afgan. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në Korfuz më 2 janar. Ndërkohë, trupi i Angeljina Petros mbërriti në Shqipëri më 8 janar dhe u përcoll për në banesën e fundit.

## "Po verifikohet roli i disa personave, mes të cilëve edhe zyrtarë shtetërorë"

# "Provat për anëtarët e grupit 'Bajri' u dëmtuan"

### Zbardhet dokumenti i Prokurorisë së Krimeve të Rënda

**TIRANË** - Pak muaj pas goditjes së grupit kriminal 'Bajri', 'News 24' dhe 'Gazeta Shqiptare' kanë siguruar një dokument të Prokurorisë për Krime të Rënda ku pranohet zyrtarisht se ka pasur tentativë kundër këtij grupi. Është përfunduar këqyrja e CD të vëzhgimeve të kryera gjatë fazës hetimore për subjektet dhe lidhjet e tyre me persona të tjerë jashtë procedimit, që në një mënyrë apo tjetër janë përpjekur të prishin, dëmtojnë apo ndërhyjnë në provat e marra gjatë hetimit të çështjes, thuhet në dokumentin e institucionit të akuzës. Burimet e prokurorisë janë tërësisht rezervuar për të dhënë detaje mbi identitetin e personave që tentuan të ndihmonin pjesëtarët e




"Forca e Ligjit" në veprim, goditët grupi "Bajri"

grupit 'Bajri' për t'i shpëtuar drejtësisë. Por mësohet se po verifikohet roli i disa personave, mes të cilëve edhe zyrtarë shtetërorë dhe lidhjet e mundshme me grupin kriminal. Që grupi Bajri kishte lidhje të forta në politikë e polici u pranua publikisht nga ministri i Brendshëm i kohës, Fatmir

Xhafaj. Pak ditë pas arrestimit të të dyshuarve, Xhafaj deklaroi në emisionin "Real Story" se "grupi 'Bajri' ka pasur influencë shtetërore në kohëra të ndryshme ndër vite, madje edhe në polici". Ai e cilësoi grupin si ndër më të rrezikshmin në vend dhe ndër më të fortët në veri. "Është një grup i

mirëstrukturuar kriminal me lidhje të forta familjare e krahinore. Një karakteristikë e grupit është se përdorun ekstremë ndaj rivalëve dhe viktimateve", theksoi Xhafaj në shtator të vitit të kaluar. Sipas Xhafaj, Bajrët e ushtronin aktivitetin kriminal jo vetëm në Shkodër, por edhe qytete të



Faksimile e dokumentit të prokurorisë

tjera, e madje edhe jashtë vendit në Holandë dhe Belgjikë. Grupi Bajri u godit pas më shumë se 6 muajsh hetime në kuadër të operacionit të koduar 'Forca e Ligjit'. Por duket se kjo kohë nuk ka qenë e mjaftueshme që institucioni i akuzës të hidhte dritë mbi aktivitetin e tyre kriminal. Prokuroria për Krime të Rënda vendosi të zgjasë afatin e hetimeve, me qëllim kryerjen e disa veprimeve që konsiderohen të domosdoshme për çështjen penale. Në duart e prokurorëve është edhe telefoni i një personi të dëmtuar nga grupi 'Bajri', në të cilin janë gjetur të dhëna të forta me rëndësi për hetimin. E ndërsa akuzat në vend po grumbullojnë informacion kundër të dyshuarve, drejtësia holandeze pritet të vendosë më 17 janar për fatin e Behar Bajrit, nëse do ta ekstradojë pse jo drejt vendit tonë.

### Rikthehet dosja ndaj Aleksandër Lucës, 3 vajza akuza ndaj shqiptarit

**GREQI** - Të tjera telashe për Aleksandër Lucën. 20-vjeçari shqiptar që ndodhet në burgun e Grevenas në Greqi, përballet me akuzat të reja në adresë të tij. Tashmë ai akuzohet për përdhunim dhe tentativë përdhunimi. Sipas mediave greke, 3 vajza e kanë akuzuar të riun shqiptar se i ka ngacmuar në të kaluarën. Një 18-vjeçare thotë se është abuzuar seksualisht prej tij. Po kështu edhe një 17-vjeçare. Kurse një adoleshente, 18 vjeç, thotë se Aleksandër Luca tentoi ta përdhunonte. Megjithatë, tri vajzat nuk kanë bërë denoncim formal në polici ndaj 20-vjeçarit shqiptar. Aleksandër Luca dhe shoku i tij grek, Manolis Koukouras akuzohen se kanë abuzuar seksualisht dhe kanë dhunuar për vdekje studenten greke Eleni Topaloudi, trupin e së cilës e hodhën më pas në det. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në fund të muajit nëntor 2017 në ishullin Rodos. Aleksandër Luca dhe Manolis Koukouras ndodhen në të njëjtin qeli, por nuk flasin me njëri-tjetrin. /tvklan.al




SHPFA: Hetim administrativ, do dalin përgjegjësit e ngjarjes së shëmtuar

# Grabitet depoja e armëve në bazën ushtarake të Pashalimanit, procedohen 5 ushtarakë

## Ushtari nuk ishte në vendrojtë, autorët morën 3 armë automatike me vlerë 8 mijë euro

VLORE

Grabitet baza ushtarake e Pashalimanit në Vlorë. Ngjarja e paprecedentë ka ndodhur të enjten, ku persona ende të paidentifikuar kanë bastisur depone të armëve. Nga raportimet e para thuhet se në këtë bazë ushtarake janë vjedhur armë të llojeve të ndryshme gjatë natës. Mësohet se ushtari që duhet të ruante armët nuk ishte në vendin e punës në momentin që ndodhi grabitja. Ndërkaq, burime konfidenciale bëjnë me dije se janë vjedhur tri armë automatike, vlera e të cilave arrijnë 8 mijë euro. Kjo vjedhje konsiderohet si ngjarje e paprecedentë, ndërsa janë shpërndarë edhe pesë ushtarakë. Menjëherë policia ushtarake dhe prokuroria kanë nisur hetimet për zbardhjen e plote të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Burimet e mësipërme sqaruan se armët kanë qenë në një tip kasaforte, e cila është hapur me forcë, ndërsa dyshohet se mund të jetë një person ose persona të brendshëm (ushtarakë) që mund t'i kenë vjedhur këto armë. Kjo për faktin se ngjarja ka ndodhur brenda bazës ushtarake të Pashalimanit, e cila konsiderohet si një nga bazat më të sigurta. Sipas informacioneve të siguruar nga "Gazeta Shqiptare", në bazën ushtarake të Pashalimanit ka shumë kamera sigurie. Ndërkohë, që i vetmi vend ku mungojnë kamerat e instaluar është pikërisht vendi ku qëndronin armët. Edhe pse kanë kaluar disa orë nga vjedhja e kësaj depeje, autoritetet ende nuk kanë bërë të mundur identifikimin apo arrestimin e personave të dyshuar. Ndërkaq, në lidhje me këtë ngjarjeje ka reaguari Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, i cili ka dënuar këtë akt, ndërsa sqaruan



Baza ushtarake e Pashalimanit

### DYSHIMI

Burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se armët kanë qenë në një tip kasaforte, e cila është hapur me forcë, ndërsa dyshohet se mund të jetë një person ose persona të brendshëm (ushtarakë) që mund t'i kenë vjedhur këto armë. Kjo për faktin se ngjarja ka ndodhur brenda bazës ushtarake të Pashalimanit, e cila konsiderohet si një nga bazat më të sigurta.

se janë proceduar 5 persona për vjedhje dhe shkelje të rregullave të shërbimit. Sipas SHPFA, për këtë rast ka nisur një hetim administrativ dhe se do të vihet para përgjegjësisë çdo individ, edhe nëse është pjesë e Forcave të Armatosura.

### REAGIMI I SHPFA

Një ngjarje e shëmtuar është regjistruar ditën e

djeshme në Bazën Detare të Pashalimanit, ku është dëmtuar një depo armatimi. Që prej momentit të parë, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, përmes të gjitha strukturave të tij vartëse dhe në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë, Policinë e Shtetit nisi zbardhjen e shkaqeve të ngjarjes, brenda

### Manjani: Lëreni Irakun dhe Afganistanin, ruani Shqipërinë!

**TIRANË** - Pas ngjarjes së ndodhur në bazën në fjalë ka reaguari ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani. Përmes një postimi në "Facebook", ai shkruan me ironi që zyrtarët dhe anëtarët e NATO-s të ruajnë Shqipërinë dhe të mos merren me informacionet e klasifikuara. "O zyrtarë, anëtarë të NATO-s!

Gjeneralë, ministra e kryeministër! Ruani depot e armëve të paktën, pa lëreni informacionin e klasifikuar se nuk ua lë njeri juve në dorë!

Është grabitur një depo në një zonë ushtarake rreptësisht të ndaluar, në Pashaliman!

Ruani Shqipërinë, lëreni Irakun e Afganistanin se nuk jeni për atë punë!

Hiqini ato policë nga universiteti e lëshojini të kapin ndonjë hajdut, se latë nam!

Degenerim i hapur...", shkruan ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani.

Bazës së Pashalimanit. Policia Ushtarake referoi dokumentet për ndjekje penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë në ngarkim të 5 personave: "Për shkelje të rregullave të shërbimit në objektet e rëndësishme" si dhe u referuan materiale për veprimet penale "Vjedhje".

Hetimi administrativ i nisur nga SHPFA po vijon dhe po merren të gjitha masat, që çdo person përgjegjës të ndëshkohet për çdo veprim apo mosve-

prim të tij, sipas ligjeve në fuqi. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dënon aktin, por në të njëjtën kohë siguron se ky rast sporadik nuk ka dëmtuar sigurinë, gatishmërinë dhe operacionaleitetin e Forcës Detare.

Thekssojmë edhe një herë se papërgjegjshmëria e ndonjë individi, qofshin ata efektive të FA, nuk mund të njolloset figurën, modelin e përkushtuar dhe sakrificën e efektive të Forcës së Armatosur Shqiptare.



**Përfundon në pranga 48-vjeçvari i kërkuar për shitje narkotikësh**

**VLORE** - Policia e Vlorës ka vënë në pranga një 48-vjeçar, i cili ishte shpallur në kërkim për prodhim e shitje droge. Bëhet fjalë për shtetasin F.B., banues në fshatin Çepër të këtij rrethi. "Seksioni për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë ka bërë ndalimin e këtij shtetasi bazuar në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë nr.344, datë 27.12.2018, e cila i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg" për veprimet penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" kryer në bashkëpunim. Materialet u kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme procedurale", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

### Krimet e Rënda lënë në qeli edhe psikologjen seksuale

## Ryshfet dhe favore seksuale, lihet në burg gjyqtari fierak Roland Hysi

**TIRANË** - Gjykata e Krimeve të Rënda dje la lënë në burg gjyqtarin e Fierit, Roland Hysa dhe psikologjen e kësaj gjykate, Elona Meçani, të përfshirë në një aferë korruptive të publikuar disa ditë më parë në një emision investigativ. Gjyqtari dhe psikologja, e cila bënte rolin e sekseres u arrestuan më 9 janar, pas skandalit të publikuar në emisionin "STOP", në të cilin ai shfaqej teksa i kërkonte një nënë të divorcuar rryshfet e marrëdhënie seksuale në këmbim të dhënies së kujdestarisë së



fëmijës. Seanca gjyqësore u zhvillua me dyer të mbyllura, ndërsa ka zgjatur afro dy orë. Gjatë fjalës së tij, 50-vjeçari Roland Hysi ka mohuar përbajtjen e videos

ku ai shfaqet duke kërkuar afere seksuale. Gjyqtari dhe avokati i tij kanë kërkuar papërdoshmëri të kësaj prove, duke argumentuar se ka një precedent, ku përgjimet pa vendim gjykatë nuk mund të jenë prove. Ata akuzohen për "Korrupsion pasiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve", si dhe për "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike". Dy ditë më parë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi pezullimin e gjyqtarit Hysa nga detyra.

### Kërkuan heqjen e masës së sigurisë arrest shtëpie

## Gjykata e Krimeve të Rënda refuzon kërkesën e dy ish-deputetëve socialistë, Ndoka dhe Çuko

**TIRANË** - Gjykata e Krimeve të Rënda ka refuzuar kërkesën e dy ish-deputetëve të Partisë Socialiste, Arben Ndoka dhe Arben Çuko për të hequr masën e sigurisë arrest shtëpie. Ata u arrestuan gjatë operacionit "Vol-vo 4" në tetor të vitit 2018. Ndoka, i dyshuar për disa vepra penale, mes të cilave "Tjetërsim pronash" dhe "Falsifikim dokumentesh", ndërsa Çuko për "korrupsion". Fillimisht u arrestua Çuko, ish-drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve (më herët ish-deputet), pasi dyshohet se merrte rryshfet në këmbim të lejeve apo transferimeve të të dënuarve. Në pranga përfundoi edhe ish-deputeti tjetër i PS-së, Arben Ndoka. Ky i fundit është arrestua së bashku me të vëllain dhe një grup pronash të tjerë, që dysho-



hen për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve", "Shpërdorimi i tokës", në kuadër të një grupi kriminal, të përfshirë në tjetërsim tokash.



EDI RAMA

**"KAPERCEJME INERCINË"**

"Falë kësaj proteste ne kapërcejmë incerinë e tepsisë së hershme. Protesta dhe e gjithë kjo shfaqje shembullore, të shqetësimeve të reja për të hapur dyert e administratës. Prioritet kanë ata që e kanë më të mirët. Ky garantohej në mënyrë mekanike, s'ka nevojë për konkurs. Vërtet arsimit i lartë ka shumë probleme, edhe Shqipëria ka probleme, por nuk mund ta krahasojmë me 5 vite më përpara", - tha kryeministri Rama.



LULZIM BASHA

**"DHUNË POLICORE"**

"Kjo është shkelje flagrante e ligjit, që ndalon futjen e forcave të policisë në ambientet e shkollës vetëm në raste të caktuara. Në shkelje të ligjit, Rama po përdor dhunë policore ndaj studentëve. Sot është shteti privat i Edi Ramës. Dua të dënoj këtë dhunë duke paralajmëruar nisur nga polici më i thjeshtë deri tek Rama, si pushtim i vendit. Ne do kundërshtojmë me të gjitha format", - tha kreu i PD-së.



FLOIDA KËRPAÇI

**"STUDENTËT JANË DHUNUAR"**

"Studentët janë rrahur dhe janë dhunuar fizikisht e psikologjikisht. Qeveria shqiptare është vendosur dhunshëm kundër çdo shqiptari! Institucionet shtetërore janë angazhuar në një grusht shteti kundër çdo shqiptari dhe fëmijëve të shqiptarëve me synimin e garantimit të pushtetit të fillqur të kryeministrit antishqiptar Edi Rama", - tha deputetja e LSI-së Floida Kërpaçi

Arkitektura dhe Inxhinieria e Ndërtimit brenda godinës, ngelin pa ushqime

# Ngujimi në fakultete, policia ushtron dhunë ndaj studentëve të Ekonomikut

Publikohet video, polici kap prej fyti të riun

**S**humë studentë të uni versiteteve publike në vënd, vazhdojnë të ngujuar në fakultete deri në plotësimin e kërkesave të tyre. Ata kanë bojkotuar mësimin e theksojnë se qëndresja e tyre do të vazhdojë. Por protesta në Fakultetin Ekonomik, mëngjesin e djeshëm, është shoqëruar me tensione të shumta (madje edhe konfrontime fizike) mes të rinjve e Policisë së Shtetit. Kjo e fundit ka tërhequr zvarrë disa prej studentëve madje në një video të publikuar, një prej policëve shfaqet tepër agresiv dhe madje ka arritur deri aty sa ka kapur prej fyti një djalë të ri. "Lëshoje, mos, lëshoje", dëgjohej thirrjet e studentëve në video ndërkohë që policia iu thotë të hapin derën. Edhe në Fakultetin Juridik, studentët vazhdojnë të ngujuar brenda godinës e shprehen se nuk do të heqin dorë. "Këtu do të rrimë! Nuk mund të na ndalojë askush, universiteti është i yni. Qeveria të plotësojë kërkesat tona, janë më se të qarta dhe lehtësisht të arritshme. Ne nuk tërhiqemi, nuk do të dorëzohemi në dorën e oligarkëve që qeverisin këtë vënd. Arsimit na përket ne dhe brezave pas nesh, edhe Shqipëria është e jona. Mjaft më!", -thotë një studente e Fakultetit Juridik për "Gazeta Shqiptare".

**NGUJIMI TE ARKITEKTURA**

Mbrëmjen e djeshme, shumë studentë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si dhe ata të Inxhinierisë së Ndërtimit janë ngujuar brenda godinës duke kërkuar plotësimin e 9 kërkesave të tyre. "Studentët të fakulteteve të ndryshme janë ngujuar në fakultetet përkatëse. Tani në fakultetin e arkitekturës e urbanistikës dhe fakultetin e inxhinierisë së ndërtimit ka studentë të ngujuar brenda. Studentëve të këtyre fakulteteve i janë bashkuar edhe studentët nga Universiteti Politeknik i Tiranës për solidarizim", -thotë studentja e arkitekturës për "GSH". Më tej studentët tregojnë se admin-



Dje në Fakultetin Ekonomik

istratori dhe kancelari i fakultetit nuk i lejon studentët të kenë hyrje-dalje nga godina, çka i pengon edhe të ushqehen. "Administratori dhe kancelari i fakultetit nuk lejon që të ketë hyrje dalje të studentëve në godinë kështu po pengohen studentët për t'u ushqyer e po shtyhen në grevë urie. Opsioni tjetër që ata na ofrojnë është të largohemi të gjithë studentët e fakulteteve të inxhinierive të tjera dhe të qëndrojmë vetëm studentet e FAU, FIN, duke dhënë emrat e tyre. Kjo gjë është shumë e dyshimtë, sepse nuk dihet se për çfarë do përdoren ato

emra, pra me të dy opsionet e tyre po ushtrojnë presion ndaj nesh", -bën me dije për "Gazeta Shqiptare" një tjetër studente. Ndërkohë studentët e fakultetit të Teknologjisë së Informacionit bëjnë me dije se policia private ka izoluar totalisht godinën dhe nuk lejojnë hyrjen e studentëve. "Godinën tonë (Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit) e kanë izoluar plotësisht kështu që kemi ardhur tek shoqët tani me qenë se na bashkon i njëjti universitet. Por di të them diçka me siguri: Ne nuk tërhiqemi!", -thekson studentja e TIK për GSH.



Një prej policëve të shtetit duke kapur prej fyti studentin

**UT, letër Policisë së Shtetit: Merrni masat për qetësi në auditore**

Nëpërmjet një letre, administratori i Universitetit të Tiranës i është drejtuar dje Policisë së Shtetit ku kërkon marrjen e masave për rikthimin e qetësisë në auditorët e UT-së. Ai thekson se disa individë të caktuar po pengojnë mbarëvajtjen e procesit mësimor. "Lutemi asistencën e Policisë së Shtetit, për garantimin e sigurisë dhe rendit publik nëpër auditorët e Fakulteteve të Universitetit të Tiranës. Prezenca e Policisë së shtetit ndihet e nevojshme në kushte kur studentët kanë filluar mësimin normalisht, por nga parashikimi i situatës në terren nga administratorët e fakulteteve, rezultoi se ka bllokime të vazhdueshme të ambienteve të Fakulteteve", - thuhet në letër.



STUDENTËT I KËRKOJNE TË LARGOHET

**Studentët e Ekonomikut përzënë deputetin e PD**

Deputeti i PD-së, Laçiano Boçi tentoi t'i bashkohej studentëve pas përplasjes së tyre me policinë në Fakultetin Ekonomik. Pavarësisht se ai theksoi se ishte aty për të larguar policinë nga ambientet e fakultetit, studentët e kanë përzënë pasi nuk duan që ngjarja të politizohet. "Kur protestojmë, del kryeministri dhe na thotë jeni të opozitës. Kur u themi deputetëve të opozitës largohuni, na thotë bëni detyrën e partisë, domethënë qeverisë. A e kuptoni sa hipokritë jeni të dyja palët? Vazhdoni jashtë, na mirëkuptoni. Ju lutem, vazhdoni jashtë. Nuk ndihemi të përfaqësuar nga asnjë deputet i Kuvendit. Largohuni!", -thënë njëzëri studentët.

**Shitje me Ankad të Pare nga Studio Perbarimore L.D.C**

"Trulli + ndërtesë" me nr. pasurie 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadasirale, 3866, me sipërfaqe totale 300 m<sup>2</sup>, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar për shitje është 3.107.280 Leka. Data e shpalljes 20.12.2018 Data e zhvillimit 15.01.2018 deri ne oren 16:00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

**Njoftim për shitje me ankad**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e pare të pasurisë të palës debitore Shoqëria "ARNI" sh.p.k, Pauria që delane ankand te pare përbehët nga:

\* Apartament , me Nr pasurie 69/11/ND +1-14 ndodhur ne Rr "Dodon", Hyrja nr.1, Kati i 3, Ap 14, Oriukim e regjistruar ne ZVRPP- Vlore, Z K Nr.2832, volumi 16, faqe 120, me siper 43 m<sup>2</sup>.

Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 1.920.000 lekë Ankandi do të zhvillohet në datën 25.01.2019 në orën 15:00 në selinë "Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakt 0672082543 ilir\_dervishaj@yahoo.com faqen WEB www.powerjustice.al.com


**Shoqëria perbarimore JUSTITIA**

Shoqëria perbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e trete, për shitjen e pasurisë së palushtetme, per te cilat ka vene hipoteke NBG Bank/BI BANK, me kate të dhëne: Lloji njesi me sip. 189 m<sup>2</sup> nr.pasurie 5/88/nd-1, zk.8350 vol 28 fq.146 RR.P.Myezari TIRANE në pronësi të Z.Ajan Rahmi BASHULLI Çmimi me të cilin fillon shitja ne ankand është 161754 (njëqinda e gjashtëqinda e një mijë e shtatëqinda e tetëqinda e katër) EUR.

\*Lloji apartament sip.132m<sup>2</sup> zk.8350 nr.pas.5/88/nd-1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Myzeqari TIRANE në pronësi të Z.Ajan Rahmi BASHULLI Çmimi me të cilin fillon shitja ne ankand është 66.528 (gjashtëqinda e gjashtë mijë e pesëqinda e njëzetë e tetë) EUR. Salla ofertues që do të marrë pjesë në ankand duhet të depozitojë si garanci shumën prej 10 % të çmimit fillestar, në llogarë në Shoqëria Perbarimore Justitia që është pranë Bankës "BKT Bank"sh.a me numër IBAN AL382051021444195CLPRCLALLA. Ankandi zhvillohet ne datën 12.02.2019 në përfundim të orës 16:30 në zyrën e perbarimorit shoqësor, me adrese Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri.

web: www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890





Pamje të studentëve të Universitetit "Luarasi" duke dhuruar gjak

Et'hem Ruka: Të kontribuojmë të gjithë së bashku. Pedagogu: Dhurimi i gjakut, akt human

Voltiza Duro

Edhe këtë vit, studentët e Universitetit "Luarasi" janë solidarizuar dhe i janë bashkuar nismës së dhurimit të gjakut, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar. Që prej themelimit në vitin 2003, ky institucion i arsimit të lartë ka treguar një sensibilizim maksimal për t'i ardhur në ndihmë personave që kanë nevojë për gjak. Prej dy ditësh, holla i "Luarasi-t" është shndërruar në një qendër dhurimi gjaku ku të rinjtë kanë shfaqur interes të lartë për të dhënë kontributin e tyre. Rektori i këtij universiteti, prof. dr. Et'hem Ruka, i bën thirrje të gjithë studentëve që t'i bashkohen fushatës së dhurimit të gjakut. "Dhurimi i gjakut në universitetin 'Luarasi' është kthyer në një traditë, që nga themelimi i 'Luarasi-t' e deri më sot nuk ka patur asnjë vit që studentët dhe pedagogët e këtij institucioni të arsimit të lartë të mos jenë përfshirë në këtë iniciativë. Të dhurosh gjak është një shenjë e lartë solidariteti njerëzor për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Pa dyshim ka më shumë nevojë për vullnetarë. Do t'u bëja thirrje të gjithë rinisë universitare, jo vetëm të 'Luarasi-t' që të përfshihen në këtë iniciativë", theksoi Ruka në fjalën e tij.

# Studentët e universitetit "Luarasi" i bashkohen fushatës së dhurimit të gjakut

## 16 vite bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar



Rektori i Universitetit "Luarasi", Et'hem Ruka

**STAFI AKADEMIK**  
Nën sloganin "Dhuro gjak, shpëto një jetë", radhëve të studentëve i është bashkuar edhe stafi akademik e administrativ i "Luarasi". Pedagogu i Fakultetit të Drejtësisë në

këtë universitet, Ernest Balli thekson se dhurimi i gjakut është një akt human për të ndihmuar sado pak njerëzit që kanë nevojë. "Në spital e në vende të tjera ka njerëz të cilët janë në nevojë dhe duhet t'i



Pedagogu i Fakultetit të Drejtësisë, Ernest Balli, duke dhuruar gjak

ndihmojmë ata. Kjo më shtyn që gjithmonë të jem i gatshëm të dhuroj gjak. Nuk është hera e parë. Dhurimi i gjakut është diçka humane në radhë të parë, por dhe diçka sensibilituese për studentët, pedagogët

e më gjerë", tha pedagogu. **TRADITA 16-VJEÇARE**  
Universiteti "Luarasi" vazhdon të ndjekë traditën për nxitjen e vlerave humane te studentët. Njëpërmyet ak-

teve të tilla, ky institucion dëshmon edhe njëherë se do të përgatisë jo vetëm profesionistë lider në tregun e punës, por edhe qytetarë model në shoqërinë shqiptare.

**APELI**  
Të dhurosh gjak është një shenjë e lartë solidariteti njerëzor për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Pa dyshim ka më shumë nevojë për vullnetarë. Do t'u bëja thirrje të gjithë rinisë universitare, jo vetëm të 'Luarasi-t' që të përfshihen në këtë iniciativë.", - theksoi Ruka në fjalën e tij.

  
 REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK  
**NJOFTIM PËR EKSPERTË DHE SPECIALISTË TË PAVARUR**

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Vendimit të KPP-së nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", KPP shpall konkurrimin për plotësimin e listës vjetore të Ekspertëve dhe Specialistëve të Pavarur në fushat:

*Ekspert vlerësimi i pasurive të paluajtshme; ekspert kontabël i regjistruar; inxhinier elektronik/informatik; inxhinier mekanik; inxhinier hidrogjigjik; inxhinier elektrik; inxhinier gjeologji-minierash; inxhinier mjedisi; inxhinier ndërtimi; inxhinier tekstile; kimist; specialist në farmaceutikë.*

**Kandidati duhet të plotësojë kërkesat:**

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën ku ai do të konkurrojë.
2. Të ketë licensë në fushat ku ligji parashikon pajisjen me të.

Pagesa dhe shpenzimet e ekspertëve apo specialistëve të pavarur do të bëhet me parapagim nga pala ankimuese.

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 08 Shkurt 2019 në selinë e Komisionit të Prokurimit Publik këto dokumenta: kërkesën për aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, fotokopje të licensës si ekspert, të librezës së punës, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, fotokopje të kartës së identitetit, numër kontakti, si dhe adresën e plotë të vendbanimit

**ALO 116: 220 vajza, pre e ngacmimit apo abuzimit seksual**

## Rreth 1100 fëmijë të prekur nga dhuna, bulizmi e shfrytëzimi

Përgjatë vitit 2018, rreth 1100 fëmijë e adoleshentë kanë denoncuar dhunën, bulizmin, si dhe shfrytëzimin për përfitime ekonomike. Ndërkohë, rreth 220 vajza të moshës 13-15 vjeç kanë raportuar se kanë rënë pre e ngacmimit apo abuzimit seksual, madje edhe në shkollë. Shifrat u bënë publike gjatë aktivitetit të 10-vjetorit të Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, ALO 116. Drejtori i kësaj platforme, Mirgjit Vataj tregon se të miturit i janë drejtuar ALO 116 për të kërkuar ndihmë edhe



për dhunën e ushtruar nga institucionet arsimore. Gjatë aktivitetit janë prezantuar edhe raste konkrete të fëmijëve që kanë rënë pre e kërcënimeve apo janë detyruar të lypin nga vetë prindërit e tyre. Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë përgjatë 10 viteve të veprimtarisë së saj ka arritur të trajtojë mbi 17 mijë raste të formave të ndryshme të abuzimit me të miturit e moshës 6-18 vjeç. Raporti tregon se gjatë 2017 në 42% të rasteve fëmijët janë dhunuar nga mësuesit, ndërsa 2018 ka shënuar 120 raste dhune në shkollë, 51 raste dhune në familje dhe 29 në shoqëri./ vo.du.

BOTIMI

# Spartak Ngjela

## "Hakmarrja e një gruaje", përdhunimi i femrave në komunizëm

Fatmira Nikolli

Historia e një gruaje që kërkon të hakmerret. Kjo është fabula ku orvatet romani më i ri i avokatit Spartak Ngjelës, i cili tashmë mund të gjendet në të gjitha libraritë. Kjo nuk është përvoja e parë e Spartak Ngjelës me shkrimin. "Të gjithë e njohin pasionin e avokatit për letërsinë, por ky pasion i ka rrënjët në një komunikim të hershëm që ai ka pasur me shkrimin. Jam njohur me disa dorëshkrime të shkruara gjatë kohës që burgut që sjellin profilin e një shkrimtari që shumë pak e njohim, dhe që vetë Ngjela kërkon ta tregojë shumë pak. Romani "Helena R" që ai shkroi pas viteve '90-të apo "Shpella e vdekjes" janë dy proza që duhet të rikthehen vëmendjes së kritikës", thotë Alda Bardhyli, e cila është dhe redaktorja e librit të të ri. Sipas saj i gjithë libri tregon historinë e një gruaje që quhet Sofie Rasku.

"Sofie Rasku nuk është vetëm një grua e bukur, por dhe një grua aspak e zakonshme. Për mes saj Ngjela evokon historinë e një periudhe të errët siç ishte komunizmi në Shqipëri duke e treguar këtë periudhë përmes raporteve delikate njerëzore. Përmes letërsisë hidhet dritë për një nga krimet më të forta të bëra gjatë diktaturës, siç është përdhunimi i femrave nga njerëz të pushtetit. Shumë pak flitet për histori që të gjithë i kemi dëgjuar treqzave, por që përmes historisë së Sofie Raskut, Ngjela denoncon një nga krimet

*Romani i ri i avokatit, kur burrat me  
pushtet abuzonin me jetët e të tjerëve*



më të shëmtuara", thotë Bardhyli. Sipas saj nuk është vetëm historia ajo që e bën këtë roman interesant, por dhe mënyra e shkrimit laborimi i thellë i psikikës së personazheve. Po ndaj kujt duhet të hakmerret kjo grua, Sofia? Ajo hakmerret ndaj përdhunuesit të saj. Pas vdekjes të së shoqit ajo mendon vetëm këtë gjë si të hakmerret. E për ta kryer

vrastjen kërkon ndihmën e një burri që gjithnjë e kish të dashur nga larg. Libri ka disa linja që të tërheqin mënyrën e rrëfimit, por dhe që na njohin me personazhe që nuk janë të larg në kohë. Nuk mungon as erosi pasi sipas Ngjelës dashuria dhe krimi ecin paralelisht. "Nuk ka letërsi të mirë pa një krim brenda dhe "Hakmarrja e një gruaje" vjen në tregun e

botimeve si një libër që jo vetëm do të provokojë një debat që gjithnjë e kemi shmangur, por edhe e bën prozën shqipe të rikthejë vëmendjen ndaj historisë", thotë ajo.


### PJESE NGA LIBRI

- Do ta vras!

Sofie Rasku ishte e bindur se duhet ta kryente vrasjen. Gjithë këtëkohë kishte sjellë në mendje gjithçka kishte ndodhur. Mbrëmjeve ky mendim bëhej torturues, kur vështrimi i ndalej në portretin e të shoqit. Sytë e tij dukeshin sikur e përndjekin, jo vetëm si një dashuri që do ta shoqërojë gjithë jetën, por edhe si një lutje që ajo përpigjej ta mendonte në mijëra mënyra, teksa orvatet nga salloni në shtrat. E ndiente se vështrimi i burrit që deshi nuk ishte thjesht një vështrim.

\*\*\*

Menjëherë sapo mbylli telefonin, Sofia shkoi të shtrihej në shtrat, sepse deri atëherë ishte duke mendur në kolltukun e sallonit kryesor të suitës. U shtri mbi krevat dhe dridhej e gjitha. Gabrieli i kishte dhënë siguri që nesër mbyllej gjithçka, sepse ashtu e kishin lënë që, kur të përmendej "nënshkrimi i kontratës", ajo çështje duhej të quej e mbyllur dhe ai kishte shkuar te vendi. Prandaj ajo e kujtoi duke ndenjur aty në njërin nga dhomat e parukerisë dhe e përfytyroi të gjithë parukerinë ashtu siç e kishte lënë, por menjëherë edhe ditën kur Aura i kishte dhënë aty fletëthirrjen e llabrave dhe e ndjeu sikur



gjithçka kishte ndodhur dhe, kurse tani e nesërmja do të sillte përfundimin e hakmarrjes së saj. Pas pak nisi të qajë, por as vetë nuk e dinte pse qante, sepse ishte e gjitha në një ekstazë që e kapi papritur sapo dëgjoi lajmin. Asaj i dukej se tani ishte kryer akti dhe kujtoi rrëmbimthi të gjithë jetën e saj, por e dinte që Gabrieli do ta filmonte të nesërmen tërë episodin e vrasjes së Seferit, sepse e kish lajmëruar për instalimin e kamerave regjistruese në dhomën ku do të vritej vrasësi. Prandaj foli në ato çaste me aq zë të ulët kur kish ardhur Flora në tavolinë, sepse nuk donte që Flora ta dinte instalimin e kamerave në atë dhomë. Të dyja kamerat ai i instaloi vetë me shumë kujdes, një natë më parë. "Do ta shoh të shtrirë dhe të gjakosur, dhe do ta dëgjoj të gjithë dialogun e tij me Gabrielin", mendonte ndërkaq e shtrirë në shtrat dhe menjëherë kujtoi fjalët që i kishte thënë Gabrieli: "Do ta kap në rrjetë një lloj si një kafshë të egër dhe do t'ia them të gjitha para sesa ta vras", prandaj ajo tani e mendoi me zë frazën e tij therëse me revole në dorë përmbi rrjetë, madje me zërin e tij dhe filloi të ndiejë një kënaqësi, si të kundërtën e vuajtjes së saj dhe qante e dridhej se kujtoi edhe Martinin, edhe Thomanë, por menjëherë edhe Gabrielin, të cilin e solli në shtrat duke fantazuar brenda një zjarrmie që e kishte pushtuar të gjithën kudo në trup. "Gabriel", tha disa herë, dhe vijoi ti përmendte vetëm emrin, dhe sa herë e përmendte, ndiente kënaqësinë e dashurisë me

të, edhe pse nuk e kishte aty. "E dashuroj", tha dhe e kujtoi edhe një herë, por e mendoi veten sesi do të rikthehej në atë kohë që kishte humbur, se e kishte përjetuar më se tri herë kur Gabrieli e mbante dhe e përkëdhelte në prehrë me fjalët e tij: ishte ndier si një njëzetvjeçare; domethënë e ndiente se ishte kthyer atje ku i ishte ndërprerë e gjithë jeta e brendshme femërore. "Do ta arrij", mendoi, gjithë po duke bërë dashuri me Gabrielin në një fantazi gati të shthurur dhe po e ndiente se do të kthehej në kohë. Vetëm femra që përkëdhelet dhe ka arritur një qëllim të saj, i cili e lumturon, vetëm ajo zbratë befas në moshë, deri në një fëmijë, deri tek ajo kohë kur i kanë filluar ndjesitë e vërteta erotike dhe ajo po e ndiente të gjitha sikur të ishte një fëmijë në prehrin e babait të saj. "Pasi ta shoh të vvarë, do ta kap moshën time 22-vjeçare dhe do të filloj t'i bëj të gjitha", mendoi duke i kaluar me radhë dridhmash orgazmat e saj, ashtu e shtrirë duke masturbuar në shtrat in vet, në shtëpinë e madhe të Hotel de Crillon. Qëndroi dikur dhe iu kujtuan shumë qartë muajt e parë të pasdhunimit, sesi i zhvlehtësohej vetja përditë e më shumë, pastaj vdekja e Martinit dhe mungesa e gjithçkaje që t'i jepte forcë. Por edhe biseda e përditshme me të atin, kur ai shpesh e më shpesh i thoshte se: për faktin që e ke goditur deri në prag të vdekjes më abazhurin tënd të shenjtë, ti e ke kaluar gjithçka". Dhe kjo i jepte një energji të brendshme që e mbikalonte





"Ai është uomo", tha për Gabrielin dhe qau sërish. Ndërkaq e kuptoi se kjo nuk ishte një qarje gruaja që vinte nga dhembja, por vetëm nga kënaqësia.

\*\*\*

Kur Sofia lexoi mesazhin e shkurtër të Gabrielit, që ende ishte duke ndenjur në sallonin e suitës së saj, po priste lajme nga Tirana. Ishte zgjuar që herët dhe në orën tetë të atij mëngjesi doli në ballkonin e suitës dhe pa në Paris një diell të bukur të sapodalë që shndriste pjacën Konkord; qëndroi aty me mendimin se po shihte historinë. Pa dhe Obeliskun dhe sikur i rrotullua nëpër vesh gjithë zhurma e Revolucionit Francez dhe kujtoi vetëm Dantonin, se atë pëlqente më shumë, ngaqë e kishte të formuar këtë mbështetje për të, me shpirt dhe me intelekt, nga Tomas Karajli, historiani i madh anglez që ajo e lexonte vazhdimisht, njëlloj si edhe i ati.

Ndenji në ballkon duke menduar gjithçka se e adhuronte pjacën Konkord, por me mendje tek ajo që po priste të ndodhte në Tiranë. "Po sikur të më vrasë ai maskara dhe burrin e dytë?" Pyeti dikur dhe menjëherë ndjeu rrahje të forta e të shpejta zemre, kur me ankth pyeti sërish: "Pse dy burra rresht do të më vrasë mua krimi?", dhe u ngrit nga karrigia ku ishte të ulur e u fut nga ballkoni në sallonin e rehatshëm të suitës. Por ora ishte 11:17 kur i erdhi mesazhi i shkruar i gjithi me shkronja të mëdha: THE END.

Për çudinë e saj nuk ndjeu gjëzim, por thjesht një cilrim të brendshëm që erdhi dhe i lehtësoi gjithçka, edhe shpirtin edhe trupin, por edhe mendjen. Si me një magji ajo kishte ndry-

mesazhin. Iu duk se e lexoi për herë të parë, sepse sa e lexoi, brenda vetes ndjeu një si afsh të ngrohtë që iu shpërhap menjëherë në të gjithë trupin dhe sikur i hoqi sërish të gjitha fuqitë. Sytë iu mbushën me lot, dhe menjëherë mendja filloi t'i punonte me shpejtësi duke shkarë teposhtë në kohën e shkuar. Kujtoi menjëherë të atin, e mandej menjëherë edhe Martinin, dhe sytë iu mbushën sërish me lot.

Nuk po e kuptonte dot se përse ishte gjithë ai mallëngjim që tani e kapi kaq befas, por shpejt i dha arsyes e vet: ishte vrasëri njeriu që iu kishte nxirë jetën. "Ja", tha ndërkaq, dhe ndenji pak se iu bë një komb në grykë, "po të mos ishte ai monstër, jeta jonë do të kishte qenë një këngë, por ai na i ktheu në një vaj". I kish vrasëri burrin pasi kishte dashur ta përdhunonte dhe ajo ka shkuar atëherë vërtetësisht mu në zgrip të vetëvrasjes. "Po", tha pas pak, "nese nuk do të ishte vrasëri Martinin, unë do të kisha vrasëri veten".

Por këtu ndenji pak, se kishte shumë kohë që s'e kishte kujtuar ndonjëherë këtë fakt dhe filloi ta mendonte si të vërtetë vetëvrasjes e saj, se me Martinin gjallë ajo nuk mund ta duronte atë që i kishte ndodhur. Madje, prandaj dhe ia kishte thënë ngjarjen e përdhunimit që, kur kjo të ikte nga kjo jetë të vetëvrasjes, ai ta dinte realisht shpëtimin e vërtetë. Por kuptohet se edhe Martinin në atë gjendje ishte ndodhur kur kishte shkuar për të vrasë Seferin: "Nese nuk do ta vras, për mua nuk do të ketë më jetë", i tha atë ditë Martinin

te aq lehtë përpara e ajo ndjehej më e lirë. Ndoshta se tashmë kishte përbushur qëllimin e kësaj jete: vrasja e Seferit erdhi pas 20 vjetësh, por sërish nga burri i saj.

Një fytyrë tjetër burri ishte shfaqur në këtë kolazh mirazhesh, duke pushtuar hapësirën përreth saj. Një burrë që ajo tashmë e ndjente nga larg. Ishte Gabriel dhe ajo ndjeu se e dashuronte.

Madje tani edhe më shumë, sepse jeta e saj ishte pastruar befas nga një ujë i qelbur që e rrethonte. Asnjëherë nuk kishte pasur një mendim të qartë se ku ishte dhe çfarë po bënte. Të gjithë e dashuronin, burra e gra, por ajo rrinte kot, sepse kishte brenda vetes atë, pengun e saj, që vetëm ajo e dinte.

"Bukuria e femrës, nese ajo nuk është e lirë, është torturë për të", kujtoi ndërkaq një shprehje të Thomait, i cili e kishte shkruar pikërisht për të dhe për jetën e saj, kur kjo nuk kishte ca ditë që e kish redaktuar. Por ndërkaq, e kujtoi qartë edhe vdekjen e Thomait, "me plagë në zëmër edhe ai", tha, dhe e mendoi qartë thënieën e tij të fundit, dhjetë minuta para se të vdiste, "Të kam dashur më shumë se jetën time; tani po të lë vetëm", dhe nga sytë i rrodhën lot, se e kujtoi që mandej, pas pak, ai vdiq, a thua se ra në një gjumë të rëndë, nga i cili nuk do të zgjohej më kurrë.

Me lotët që i rridhnin, i doli si në një pasqyrë e gjithë jeta e vajzës dhe u kujtua që, edhe qenia e saj e kishte mbajtur për ta larguar nga vetëvrasja. Iu kujtua pyetja që kishte bërë kur i sollën trupin e Martinin në shtëpi: "Po Silvana, Silvi i vogël, çfarë fajka që të mbetet edhe pa baba, edhe pa nënë", dhe e ndjeu që kjo pyetje sërish i dha forcë, por tani edhe më të madhe, se e ndiente që po fillonte një jetë të re. "Nesër vjen Gabriel!", mendoi dikur dhe mblodhi këmbët dhe sërish e gjeti veten duke qarë, pa e ditur se përse i kishte ardhur gjithë ky mallëngjim.

Në fakt po qante dy të vdekur që nuk i kishte aty në këtë lajm: Thoma Dunin dhe Martin Raskan; babanë e saj dhe babanë e vajzës së saj. Por kujtoi dhe një herë Gabrielin që do të vinte të nesërmen nga Milanoja me Alitalia-n, dhe filloi të dremiste mbi kolltukun e bollshëm dhe të rehatshëm, duke sjellë në kujtesë esenë e saj "Shpirt gruaja", dhe tha me vete duke folur me pak zë:

"Dashuria që ka mbushur një grua nuk është e njëllajtë me dashurinë që përcjell ajo. Dashuria që përcjell gruaja, s'është gjë tjetër veçse një shpirt gruaja. Janë të paktë ata burra që e kanë përjetuar këtë përcjellje, sepse janë të paktë edhe gratë që e përcjellin kështu. Por në Shqipëri kjo ende nuk kuptohet plotësisht".

## BASIR MAHMOOD NGA LAHORA NË TIRANË

Platforma e Artit Bashkëkohor Harabel mbajtur të mërkurën një bashkëbisedim me artistin pakistanez Basir Mahmood. Artisti Basir Mahmood, lindur në Lahore (Pakistan) më 1985, aktualisht banues në Lahore dhe Amsterdam, në bashkëbisedimin që zhvilloi, iu përmbajt asaj që ai e cilëson trajektorja e artistit, nisur nga veprat që ai ka bërë në kohë të ndryshme gjatë karrierës së tij. Që prej vitit 2011 ai ka marrë pjesë në rezidenca të ndryshme artistësh në mbarë botën për të zhvilluar praktikën e tij. Megjithatë e filloi me "Akademie Schloss Solitude" në Shtuttgart (2011-12) dhe erdhi në "Rijksakademie van beeldende kunsten" (2016-17) në Amsterdam, ai e mbylli përfundimisht një përvojë të tillë, duke e cilësuar këtë si pjesëmarrjen e tij të fundit për çdo qëndrim rezidencial. Mahmood-i shpesh i mëshon mendimit se ai u bë artist duke parë artistë të tjerë, përfshirë edhe pjesëtarë të familjes së tij, si dhe ata që takoi gjatë qëndrimeve të tij artistike (rezidencave). Rrjedhimisht, mund të thuhet se të mësuarit duke vëzhguar të tjerët vlen më së miri edhe në punën e tij. Ai shpreh fiton aftësi dhe profesione të ndryshme për të përcjellë atë që sheh, duke arritur një ndjekje (audiencë) përherë e më të gjërë. Artisti kishte përzgjedhur disa nga filmat e tij për këtë takim si një mënyrë për të shpërfaqur ecurinë e tij të të menduarit e për të vijuar më pas në një diskutim publik. Filmat që do të shfaqen janë: "Manmade" ("Shndërrimi"); "My Father" ("Babai im"); "In a Move, to the Better Side" ("Në lëvizje, në anën më të mirë"); "Thank You For Coming" ("Faleminderit që erdhët"); "Power Between Weak" ("Fuqia e të pafuqishmit"); "Practicing Procedures of Killing" ("Duke ushtruar veprimet e vrasjes"); "Monument of arrival and return" ("Përmendorja e mbërritjes dhe e kthimit"); "All voices are mine" ("Të gjithë zërat janë të mitë").



### ARTISTI

Artisti Basir Mahmood ka lindur më 1985 në Lahore, Pakistan. Ka studiuar në Universitetin Kombëtar "Beaconhouse" në Lahore dhe ka marrë një bursë njëvjeçare nga "Akademie Schloss Solitude" (Shtuttgart, Gjermani) në vitin 2011. Duke përdorur video, filma apo fotografi, Mahmood-i thur tema të ndryshme në copëza poetike dhe mënyra të larmishme rrëfimi.

Që prej 2011-s, veprat e tij janë shfaqur gjerësisht, duke përmendur këtu: Kopshti i Edenit, Pallati i Tokios, Francë, 2012; Bienalja e tretë Ndërkombëtare e Moskës për Artin e Ri, Rusi, 2012; Hapja përruruese e "Broad Museum"-it, Universiteti Shtetëror i Miçiganit, SHBA, 2012; Trienalja e Azisë së Paqësorit (APT 7) në Galerinë e Arteve në Kuinsland (Queensland), Brisbane, 2012; Bienalja e Sharjahut 11, Emiratet e Bashkuara Arabe, 2013; "Des hommes, des mondes at college des bernardins" ("Njëzetit, botët në kolegjin e bernardinëve"), Francë, 2014; "Time of Others" ("Koha e të tjerëve"), Muzeu i Artit Bashkëkohor, Japoni, 2015; Bienalja e Yinchuan-it, Yinchuan, Kinë, 2016; Shfaqja e Çmimit Abraaj për Artin (Abraaj Group Art Prize show), Emiratet e Bashkuara Arabe, 2016; Bienalja "Contour" 8, Gjermani, 2017; "Tablotë e gjalla" ("Tableaux Vivants"), Fondazione Etrillard, Francë, 2017; Bienalja e dhjetë e Berlinit për Artin Bashkëkohor, Gjermani, 2018.

Përveç të qenit pjesë e koleksioneve të ndryshme private, veprat e tij (video) janë bërë pjesë e koleksionit të Galerisë së Arteve në Kuinsland (Queensland) në Brisbane, Australi dhe Qendrës Kombëtare të Arteve Plastike (Qendra Kombëtare për Artin Pamore) në Francë. Mahmood-i iu dhënë një bursë dyvjeçare kërkimi në "Rijksakademie van beeldende kunsten" në Amsterdam (2016-2017); Granti i Programit të Prodhimit nga Fondacioni i Artit Sharjah (2016) dhe Bursa për Artistë të Formuar nga Fondi Mondrian (Stipendium for Established Artists from Mondriaan Fonds) (2018-2022).

situatën e zhvlehtësimit të vetvetes. Por pastaj, shumë vjet më vonë, vetëm para një viti, ajo e lexoi në ditarin e Thomait të plotë mendimin e tij për gjendjen e saj. Ai shkruante: "Për faktin që Sofia e ka goditur pas koke agresorin e saj përdhunues me një send të fortë, dhe e la atë pa ndjenja, dhe pa e kryer dot aktin përdhunues kundrejt saj unë e pashë vetë, sesi ajo shumë shpejt më pas, kaloi nga një viktimë të një mbijetuar". Gruaja e ka tmerr këtë dhe këtu në të vërtetë vjen e ngjizet më pas e gjithë revolva e saj hakmarrëse që nuk pushon dot kurrë. "Nuk mund ta harroj këtë", nëpërdhëmbi ajo ashtu e shtrirë në shtrat dhe së brendshmi e ndjeu sërish valën e ngrohtë që e preku si një gjëzim të pritshëm kur e mendoi e sigurt se harrsa do t'i fillonte nesër me zhdukjen nga kjo jetë të njeriut që i kishte marrë njëzet vjet jetë: "plot njëzet vjet", tha sërish e shtrirë dhe me sy të mbyllur, dhe me një frymëmarrje të plotë gruaja. Sakaq kujtoi mendimin e Thomait që i kishte thënë: "Nuk mjafton vetëm mendimi se ke përballuar gjithçka nga dhunimi yt, por ti duhet ta harrosh"; ja, kjo ishte e gjitha dhe ajo tani po ndihej e sigurt se, pas vrasjes së Seferit, ajo do të harronte gjithçka, sepse nuk mbetet më asnjë gjë që ta bënte të kujtonte trishtimin e një vuajtjeje tmerruese. Ajo tani kishte dhe dashurinë për një burrë, dhe kjo e shtyu ta mendonte se gjithçka do të vinte e të ecte nga e para.

### Bardhyli: Historia e Sofie Raskut, Ngjela denoncon një nga krimet më të shëmtuara

shuar formë dhe trajtë njëherësh. Ishte në kolltukun e madh të sallonit e veshur me një palë pantallona të bardha që italianët i thonë bianco sporco, dhe me një bluzë të kaltër me mëngë të gjata, kur befas i la pantoflat poshtë mbi tapet, ngriti këmbët dhe u shtri e kumbisur në kolltuk. Po merrte frymë thellë dhe as vetë nuk e dinte se çfarë të bënte dhe çfarë duhet të mendonte. Nuk mendonte dot për asgjë, por e ndiente veten sikur sapo kishte dalë nga një masazh magjik. Donte të fliste me dikë, por e kishte të pamundur. Aurën e kishte telefonuar që një natë më parë dhe e kishin lënë që të takoheshin pas orës 12:00, po pa e lënë saktë se kur.

Po rrinte shtrirë dhe e mori në dorë edhe një herë telefonin dhe lexoi sërish

Sofisë, një orë para se të shkonte për të vrasë Seferin. Tani, me dorën të balli dhe e shtrirë me shpinë në kolltuk, e dëgjoi nëpër vesh të gjithë këtë shprehje, dhe lotët i zbritën lehtë mbi fytyrë.

Gjatë këtyre viteve pa të, ishte përpjekur mos ta sillte në kujtesë këtë shprehje ashtu si çdo gjë të trishtuar që ia bënte dhembjen më të fortë. Kishte dashur ta kujtonte gjithnjë bukur, me duart e tij nëpër flokë. Por tashmë pas 20 vitesh, teksa mori lajmin e vrasjes së Seferit, portreti i tij bashkë me zërin në dhomën e tyre teksa fuste revolverin në brez, i orvatashin në mendje.

Nuk ia kishte thënë kurrë vetes këtë episod, por sot, ashtu e shtrirë në kolltukun e sallonit, gjithë jeta e kaluar me të, kalon-



### TERMS OF REFERENCE

Internship opportunity with UNHCR in Albania

**Organizational Unit:** UNHCR Country Office, Tirana/Programme Unit

**Duty station:** Tirana, Albania

**Type of Contract:** Internship (Full Time)

**Duration:** Three months with possibility of extension

**Expected start date:** 15 February, 2019

**Application deadline:** 25 January, 2019

#### Background information/Organizational Context

UNHCR provides support to asylum seekers and refugees who seek protection in Albania and after receiving status opt for local integration as a durable solution to their situation. UNHCR in Albania operates with different partners among them, local NGOs, UN Agencies and Governmental Institutions to implement its planning on a yearly basis. Implementation of activities is overseen and monitored also by programme unit and as such a series controlling mechanisms for monitoring and reporting are in place.

#### Duties and Responsibilities

- Draft as an initial form the Monitoring of Partners tool kit which contains 7 forms among which the risk assessment and monitoring plan. This kit will be prepared for 5 partners.
- Participate and assist the Assistant Programme officer in verification visits to the partner for MYR.
- Prepare initial draft of the verification reports upon completion of visits
- Draft the audit reports matrix and actions and implementation timeframe for three partners
- Draft documents upon request
- Follow up and monitor the activities of coaching of IRCA partner and report accordingly
- Assist the programme unit in expenditure and other reports for MYR
- Organise seminars and meetings
- Draft and finalise minutes of meetings in programme unit
- Assist programme unit in administrative tasks as required

#### Minimum qualifications required

- In order to be considered for the internship, the following criteria must be fulfilled:
- Recently graduated from university or currently enrolled in graduate/undergraduate school at university and completed at least two years of undergraduate studies in Finance and Economics, Public Administration or related field.
  - Fluency and good drafting skills in English and working knowledge of another relevant UN language or local language.
  - Strong analytical planning and organizational skills.
  - Command use of Excel spreadsheets



### TERMS OF REFERENCE

Internship opportunity with UNHCR in Albania

**Organizational Unit:** UNHCR Country Office, Tirana/Protection Unit

**Duty station:** Tirana, Albania

**Type of Contract:** Internship (Full Time)

**Duration:** Three months with possibility of extension

**Expected start date:** 15 February, 2019

**Application deadline:** 25 January, 2019

#### Background information/Organizational Context

Accession to the European Union will remain the overriding priority of Albanian government, particularly if the negotiations are opened in June 2018. The focus on EU accession provides opportunities for UNHCR to strengthen legislation and procedures in line with international and EU standards. During 2018, the number of arrivals of asylum-seekers/refugees and asylum requests substantially increased as compared with previous years. UNHCR estimates that some 60% of those arriving and requesting asylum are from refugee-producing countries. The Government with UNHCR's and partners' support has expanded reception capacities to cope with the increased mixed movement of persons entering, transiting and requesting asylum in the country. Although the vast majority of those arriving leave the country after a few days, the Government and UNHCR are jointly working to enhance asylum procedures and coordinate efforts to provide solutions for both those willing to enjoy international protection in the country and for vulnerable asylum-seekers.

The protection intern will be under the direct supervision of the Protection Associate and will work closely with the multidisciplinary team at the National Reception Centre for Asylum-seekers as well as the Child Protection specialists involved in providing services to children at risk.

#### Duties and Responsibilities

- Facilitate information sessions on asylum procedures at the National Reception Centre for Asylum twice a week.
- Conduct profiling interviews with asylum seekers at the National Reception Centre for Asylum twice a week.
- Support the information management officer with data entry regarding asylum seekers profile and protection incidents reported during the interviews.
- Support the protection team with translation of legal documents, memos, internal reports, notes for the file, and other relevant documents in English and Albanian.
- Provide support with other tasks as may reasonably be required.

#### Minimum qualifications required

- In order to be considered for the internship, the following criteria must be fulfilled:
- Recently graduated from university or currently enrolled in graduate/undergraduate school at university and completed at least two years of undergraduate studies in International Law, Political Science or related field.
  - Fluency and good drafting skills in English and working knowledge of another relevant UN language or local language.
  - Strong analytical planning and organizational skills.
  - Command use of Excel spreadsheets.

#### Application and Selection

Interested candidates are kindly advised to submit CV and motivation letter, as well as certified copies of diplomas or proof of enrolment in graduate or undergraduate studies, by e-mail to [albt@unhcr.org](mailto:albt@unhcr.org). In the subject line please indicate 'UNHCR - Albania, Protection Internship'. Deadline for application: 25 January 2019.

Note: Food and local transportation allowance will be provided to interns who don't receive financial support from an outside part.

An individual whose father, mother, son, daughter, brother or sister is a staff member of UNHCR, including a Temporary Appointment holder or a member of the Affiliate Workforce, is not eligible for an internship with UNHCR.

Only short-listed candidates will be contacted.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

### OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION

#### 1. GENERAL CONDITIONS

- 1.1. **Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1
- 1.2. **Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in: Economic development, Economic legal reform, Vocational education and training, Reform of the water sector, Rural development, and some other areas
- 1.3. **Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified furniture companies to express their interest in providing the below supply and services:  
Office Desk (L-shaped)  
Office Desk (160x80x72)  
Movable Drawer Locker Unit  
Meeting Table  
Office etagere  
Small Meeting Table (square)  
Book Shelves  
Swivel Chairs  
Regular Fixed Chairs  
Stand for working stations division

#### 2. Companies should fulfill the following requirements:

- 2.1 The products must be certified according to European standards.
- 2.2 The company should be an authorized service provider for the products it will offer
- 2.3 Have implemented similar projects in the past.
- 2.4 Provide evidences of brand certified professionals, who will implement the solution.
- 2.5 The bidders must provide actual technical brochures of the types and models and specifications of the furniture offered.
- 2.5 Professional services: To implement successfully all the above-mentioned equipment's and to integrate them accordingly it will be necessary that the bidder be able to quote the necessary services. Therefore, it is needed to quote the following services:

- Site survey and planning (scheduling)
- Mounting equipment
- Testing the deployment
- Installation report

All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: [giz-albanien@giz.de](mailto:giz-albanien@giz.de)

3 The **due date** for submitting the application is **24 January 2019**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Furniture and Equipment", addressed to:

**German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana,  
Rr. Skenderbeg, No. 21/1  
Tirane**

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

# BalkanWeb.com

**AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.**



**MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET**



**INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID**







# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 643

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 12 Janar 2019

## E VERTETA E LIDHJES NA BENE LEMSH, POR S'SHPËTOJNË DOT, FLORI DHE KEJSI JANE ÇIFT



Mërzitem edhe unë me ty ndonjëherë  
Më shumë për gjëra të tilla që nuk kanë vlerë  
Por e gjej gjithmonë një formë më fal të them  
S'te përjet dot përmendësh ti më rreth

Pas Enit dhe Gencit radhën e kanë këta VIP-a për t'u fshehur. Foto, sinjale, komente dhe fjalë me nënkuptim

## FERO-ARBENITA "Shok-shoqe", termi i ri i çiftit




"BEL MONDO"

## XHANI SHQERRA JETA PËRTEJ EKRANIT E MODERATORIT MË TË RI




## PAS FOTOS NË BANJË VIJON FOTOSHOPI, ENCA PROVOKON ME TË BRENDSHME TYL





## Habit Evi Reçi, rikthehet në muzikë me një këngë dedikuar një vajze të njohur?

Ajo i ka munguar shumë skenës shqiptare, pasi ka kohë që nuk ka sjellë një klip të ri. Por rikthimi duket se do të jetë shumë i shpejtë. E ftuar në 'Pop Culture', këngëtarja Evi Reçi i ka zbuluar planet e afërta. Nga video e shkurtër e publikuar me momente të emisionit, Evi tregon që shumë shpejt do publikojë një këngë të re. "Projekti i ri do ketë shumë ritëm dhe aty i këndoj një vajze që njihet në Shqipëri", -u shpreh Evi pa zbuluar më tepër për këngën e re. Më tej këngëtarja ka zbuluar edhe plot detaje për jetën në Itali ku është shpërngulur prej kohësh. Mesa duket rikthimi në muzikë i Evi do të jetë i fuqishëm, por kush të jetë vajza që këngëtarja t'i ketë dedikuar këngë?



## Kudo i shohim bashkë, por Alba nxehet kur e pyesin për 'lidhjen' me Albin

E dhe pse ka kaluar më tepër se 1 vit që mediat kanë publikuar foto që vërtetojnë se koreografi Albi Nako dhe balerina e tij Alba Hoxha janë bashkë, kjo e fundit vijon të mohojë publikisht të jetë e lidhur me të. Në fakt, lajmin se mes dyshes ka nisur një histori dashurie e konfirmojnë edhe burime pranë çiftit, por, megjithatë, kur njëri prej ndjekësve e ngacmon për Albin në 'Instagram', Alba përgjigjet e acaruar dhe negativisht. Së fundmi, prezantuesja e motit në Tv Klan ka publikuar dy foto pranë oxhakut ku shkruan "Ngrohtë vetëm pranë oxhakut...", një ndjekës e ka plotësuar fjalinë me komentin "edhe Albit". Por ky koment e ka nervozuar Albën, e cila vetëm pak ditë më parë ishte po me Albin në Brezovicë duke iu përgjigjur: "Nuk jam e lidhur me Albin se më çmendët". Pse kaq e vështirë ta pranojë një gjë që të gjithë e dinë?!



## Na ka ngatërruar të gjithëve! Ja mbiemri i vërtetë i këngëtarit

Në postimin e tij të fundit në rrjete sociale këngëtarit, Alban Ramosaj ka bërë të flitet shumë për të. Ai ka publikuar fotën e pasaportës dhe një bilete avioni, ku tregon se do të realizojë një udhëtim. Megjithatë ndjekësve, duke qenë se janë të vëmendshëm në çdo detaj, u ka bërë përshtypje mbiemri i këngëtarit, i cili nuk është Ramosaj, por Kamerolli. Duket se edhe Albani edhe Beatrix kanë mbajtur në art mbiemrin e nënës së tyre, duke qenë mjaft të njohur në publik. Ç'ne një vendim i tillë?



## Pritej dasmë, por s'u bë, Samanta Karavella flet për martesën "e shumëpritur"

Ajo vijon të jetë një nga njerëzit publikë më të rezervuar për jetën e saj private dhe gjithmonë preferon që lajmet lidhur me të t'i japë përmes 'logarisë në 'Instagram'. Edhe pse para një viti, Samanta Karavella, u shpreh se do të martohej verën e ardhshme, duket se planet për të veshur vellon e bardhë, këngëtarja bukuroshe i ka shtyrë sërisht. Këtë herë Samanta nuk ka treguar afat se kur fansat e saj do ta shikojnë të veshur nuse, por tha që ka hequr dorë nga martesë. Madje, Samanta nuk ka pranuar të pohojë nëse është në ndonjë lidhje serioze, apo jo. E ftuar në emisionin "Wake Up", Samanta tha duke qeshur se edhe fisi i saj ka hequr dorë nga kërkesa për ta martuar, pasi ajo e ka mendjen tek muzika. Edhe pse shpesh herë këngët e saj kanë qenë hite duke arritur majat e suksesit, Samanta nuk ka dhënë detaje për jetën e saj personale. Ajo ka zgjedhur gjithmonë t'i mbajë sekret lidhjet e dashurisë. Kujtojmë se para disa vitesh, ajo u nda nga i dashuri që kishte lidhje prej afro 2-vjeçare. Ndërkohë, para një viti, në media u përhap lajmi se Samanta Karavella, ishte në prag të martesës. Kjo e indinjoi Samantën, e cila i quajti mediat si 'ngatërrestare' dhe ironizoi se do të martohej verën që vinte (2018). Mesa duket u prishën planet edhe këtë herë për dasmë, të presim vitin tjetër tani kur të na i bëjë surprizë!








## Pas fotos në banjë vijon fotoshopi, Enca provokon me të brendshme tyl

**E**dhe pse u kap 'mat' para disa ditësh në banjë në një foto të bërë në çast, Enca nuk po i ndalë pozat provokuese, gjithashtu, edhe fotoshopin! Këngëtarja po vazhdon me pozat e fotosesionit që ka bërë në të brendshmet neon i gjelbër, tyl. Ajo shfaqet sërish në të brendshme, imazhe këto të ndara nga fotosesioni i saj i fundit. Në fokus të kësaj fotografie ishte sërish gjoksi bombastik i këngëtares ndërsa në të parin kishte vënë në pah falë fotoshopit vitet dhe gjoksin, kurse mbishkrimi që i kishte vendosur kësaj të fundit ishte "Përse më doni mua?"



## Afërdita kujton të atin e ndjerë, rrëfen amanetin që i la para se të ikte

**K**ëngëtarja e njohur, Afërdita Dreshaj ka treguar shpesh herë se ëndrra e babait të saj ishte të bëhej këngëtare. E pyetur nga ndjekësit se sa e kishte të vështirë t'i realizonte ëndrrat pa babain, ajo thotë se është munduar ta çojë deri në fund amanetin. "Ëndrra e babait tim ishte të bëhesha këngëtare, kur unë isha 12 vjet ai ishte ende gjallë dhe më mori ta inçizojë këngën e parë... kur ai vdiq e kisha shumë të vështirë të vazhdoja, por duhet t'i tregoja atij që do të vazhdoja ëndrrën e tij dhe timen, nëna ime është femra më e fortë dhe më ka dhënë krahë tjerë të vazhdoj", është përgjigja e saj. Së fundmi Afërdita ka paralajmëruar rikthimin në muzikë pas një pauze të gjatë që bëri.



## Fejohet Ervini i 'Big Brother', rrëfen lidhjen me drejtoreshën në Amerikë

**E**rvini ka qenë një ndër personazhet që spikatën më tepër në edicionin e fundit të 'Big Brother'. Prej gati 1 viti ai është zhvendosur në SHBA. Largimi i tij nga Shqipëria erdhi për shkak të karrierës së tij si model, por që gjatë qëndrimit atje ka njohur edhe dashurinë e jetës. Në një intervistë të dhënë për një media rozë, Ervini ka rrëfyer se pak ditë para ndërrimit të vitit ai dhe e dashuria e tij shqiptare janë fejuar dhe modeli i ka dhuruar asaj një unazë ar të bardhë me 3 karat diamante. "Unë dhe partnerja ime u fejuam para mbylljes së vitit 2018. I propozova ditën e Thanksgiving. E propozova te vendi ku u njohëm për herë të parë. E fejuara, një bukuroshe bionde, është shqiptare dhe bashkëjeton prej pak kohësh me ish-banorin e 'Big Brother Albania'. "Me vendosjen në Amerikë, unë punoj në "Building remodeling Manhattan", ndërsa e fejuara ime tashmë punon si drejtoreshë e Burimeve njerëzore në një kompani këtu. Ne u njohëm nga një shoqëri e përbashkët dhe që nga ajo ditë jemi bashkë", tregon ai. Për sa i përket planeve për martesë, ai pranon se hapat e tjerë do t'i bëjë avash, pasi sipas tij vendimet e marra shpejt nuk zgjasin.





Pas Enit dhe Gencit radhën e kanë këta VIP-a për t'u fshehur

# Na bënë lëmsh, por s'shpëtojnë dot, Flori dhe Kejsi janë çift

Pamela Aliaj

Foto, sinjale, komente dhe fjalë me nënkuptim, e vërteta e lidhjes

Fero me Arbenitën, Alba me Albin, Luana me Krenarin, e shumë e shumë çifte të tjera po na e 'plas' shpirtin duke mos pranuar lidhjet e tyre. Pikërisht si kënga e tij, e cila rrëmbëu edhe kupën në "Kënga Magjike 2018", kantautori i njohur Flori Mumajesi po na 'plas' me pëshpërimat dhe dyshimet e ngritura lidhur me marrëdhënien e afërt që mund të ketë me këngëtare Kejsi Tola. Por ndërkohë, që ai me krijimin e tij i këndonte një dashurie që s'është më (dhe që shumë aluduan se bëhej fjalë për Elvana Gjatën), nga ana tjetër, dukej se ajo që e ngushëllonte ishte Kejsi Tola, me këngën "Më ke mua", një krijim po ashtu i Flori Mumajesit, që fitoi çmimin e "Produksionit më të mirë". Të jetë rastësi? Viojmë me detaje të tjera. Para se t'ju rreshtojmë gjithë detajet që shumë nga ne i kanë vënë re dhe publikisht nëpërmjet video-ve dhe sinjaleve të tjera nëpërmjet rrjete sociale, burime shumë të afërta të këngëtares kanë thënë për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" se Kejsi dhe Flori kanë nisur romancën që në fillim të verës së vitit të shkuar. Pavarësisht detajeve të tjera tërhiqje e mos e këput, ata në fakt janë një çift dhe po shijojnë romancën e tyre në formë loje para kamerave duke na vënë shpesh



në dyshim, por ja që e vërteta qëndron kështu. Ndërkohë nëse i rikthehem detajeve të tjera rikujtojmë fillimisht se Kejsi Tola nuk pushonte me falënderimet për kompozitorin e këngës, pra për Flori Mumajesin. Në "E diela shqiptare" të dielën e shkuar, teksa shprehte vlerësimin ndaj tij, Flori u përgjigj: "S'ka problem, më ke mua". Të gjithë mbetëm pa fjalë, kur Flori nuk e la vetëm dhe vrapoi drejt saj të vallëzonte në skenën e "E diela shqiptare". Vështrimet që ata i hidhnin njëri – tjetrit gjatë vallëzimit, dukeshin aq të ngrohta si të ishin të dashuruar. Nuk mbaron me kaq, këngëtar publikoi foton ku kapeshin dy duart e tyre, ndërsa lart shkruhej një pjesë e tekstit të këngës. Në darkën e artistëve të "Kënga Magjike", Kejsi qëndronte e ulur pranë Florit. Rastësi?! Viojmë! Flori publikon në "Insta Story" një foto të Kejsit, duke buzëqeshur nga studio, të cilën e shfaqëron me emoji-n e një zemre. Mirëpo, duket se këto veprime nuk janë të kota, pasi ata janë realisht në një lidhje romantike. Nga ana tjetër mediat rozë raportojnë se çifti ka rreth gjashtë muaj së bashku dhe janë treguar tejet por ja që detaje të tilla, të sjella vetë nga ata, nuk i kanë lënë dhe aq diskretë. Së fundmi, fakti që ata nuk reagojnë për lajmet në media, e thellon akoma më tepër të vërtetën. Por pavarësisht të gjithave, sinjale apo jo, ata përbëjnë vërtet një çift shumë të veçantë së bashku!

## Hygerta Sako prek me foton nga fëmijëria: "Ishim të varfër, por..."

Të gjithë bëhemi shpesh herë nostalgjikë për atë që shumë e konsiderojnë si pjesën më të bukur të jetës, fëmijërinë, mbetet e madhe. Kjo gjë i ka ndodhur dhe moderatores sportive, Hygerta Sako, që ka nxjerrë nga sirtaret një foto të ditës së parë të shkollës, përmes të cilës kujton se pavarësisht vështirësive që ka pasur ai brez, kohë e kaluar në vegjëli, ka qenë e bukur. "1 shtator 1983 dita e parë e klasës së parë. Flokët sikur m'i kanë prerë me tas, fustani me copën që kishte tepruar nga perdet (edhe pse qëndisur mjeshtrorisht nga motra) dhe duke përfaqëuar lulen e duke buzëqeshur gjasme se kështu më tha xhaxhi fotografi. E megjithatë, edhe pse të varfër, më ka marrë malli për atë fëmijëri të pastër e të vërtetë", shkruan Hygerta në foton e postuar në "Instastory". Jetë e vështirë për ish-misin, por që arrin ta vlerësojë për të kujtuar si ka arritur aty ku është!







Pamela Aliaj


Vetëm tri ditë më parë modelja e njohur shqiptare Arbenita Ismajli publikoi foton e parë në çift me partnerin e saj, reperin Fero si për të provokuar mediat, por edhe si përgjigje e deklaratës së bërë nga repieri në një intervistë të dhënë. Bukuroshja konfirmoi në këtë mënyrë ndjenjat e saj ndaj Feros, dhe prej kohësh përfliete për lidhjen me reperin. Megjithatë ajo që tërhoqi vëmendjen ishte mbishkrimi i saj në foto. Arbenita i referohej partnerit me termin "shoku" dhe të njëjtën gjë ka bërë edhe Fero. Së fundmi ai publikoi një foto me Arbenitën, të cilën, gjithashtu, e quan shoqe. "Aaa shoqe, shoqe", shkruan Fero në koment. Reperi ka bërë edhe një veprim që me siguri nuk u ka pëlqyer fansave. Ai ka bllokuar komentet në 'Instagram', dhe me sa duket nuk do të lexojë asnjë gjë për partneren dhe veten. Ndërkohë që kujtojmë se që prej muajve të fundit të 2018 të gjithë flisnin për lidhjen e saj me Feron. Arbenita Ismajli na kishte dhënë një provë vërtet domethënëse për ndjenjat e saj ndaj reperit. Në një foto të publikuar në muajin dhjetor, modelja simpatike shqiptare mbante në qafë një varëse në formë medalioni në të cilën shkruhet emri i saj dhe i reperit: "Fero, Nita". Ajo e ka publikuar që më 26 dhjetor foton me varësen që besojmë se është një dhuratë për modelen bukuroshe, ndërsa përkrah saj shkruan: "Njerëzit duhet të bien në dashuri me sytë e mbyllur". Me sa duket Arbenita paska rënë në dashuri kokë e këmbë me reperin nga Kosova dhe kjo foto është vetëm një provë. Dhe më në fund, pas 'plasjes' së mediave rozë për aludimin se të dy ishin bashkë, modelja vendosi ta bëjë publike lidhjen që ka disa muaj që ka



**E pranojnë edhe këta! Modelja ka dhënë provën më të madhe për të dashurin e saj**

## "Shok-shoqe", termi i ri i çiftit Fero-Arbenita

*Me shaka apo jo, të dy e pranuan më në fund lidhjen e tyre!*



nisur, duke publikuar në profilin e saj në 'Instagram', dy foto bashkë me Feron ku sh-

kruante: "Me shokun" dhe ajo që bën akoma më tepër përshtypje është fakti se model-

ja nuk ka lejuar që të bëhet asnjë lloj komenti në foto duke i bllokuar ato. Ndërsa në ditët

e para të janarit reperi Fero jep një intervistë ku e mohon totalisht marrëdhënien me Arbenitën duke e quajtur atë thjesht shoqe. Shkaku i shpërthimit të lajmit se mes reperit Fero dhe modeles së njohur Arbenita Ismajli ka një lidhje sentimentale u bënë fotot ku dyshja shfaqeshin në të njëjtat vende dhe komentet mes tyre. Si Fero, edhe Arbenita nuk i kursenin fjalët e ëmbla ndaj njëri-tjetrit, dhe kjo bëri që lajmet mbi lidhjen e tyre të shtoheshin edhe më shumë. Mirëpo e vërteta është që Fero nuk është në një lidhje me Arbenitën, pasi me të ka një marrëdhënie tjetër, atë të miqësisë, të paktën sipas tij. I pyetur në "Sevenbi-zz", nëse është i lidhur apo jo me Arbenitën, Fero u përgjigj: "E kam shoqe shumë të mirë, shoqe të ngushtë dhe asgjë më shumë". Lidhja e tyre u zbulua në tetor të 2018-s dhe çifti e konfirmoi përmes komenteve në postimet e publikuara në rrjetet sociale. Por tashmë me mbishkrimin e vendosur ndaj njëri-tjetrit "shoku-shoqja" asnjë nuk bëhet konfuz, sepse ata më në fund e pranuan se janë një çift dhe tepër të dashuruar madje, këtë e tregojnë vetë fotot!

## Rrëfihet moderatori: Dua të përçoj vlerat e një bote të bukur

“Bel Mondo” e

# Xhani Shqerrës, jeta përtej ekranit e moderatorit më të ri të familjes ‘Klan’!

Pamela Aliaj

**P**o të hapim profilin e tij, e shohim që ka eksperimentuar shumë në jetë dhe në moshë tepër të re është bërë i njohur falë muzikës së tij. Më vonë, si model në pasarellet e ikonave të modës e së fundmi si moderator. Duket se ekranit është një nga dashuritë e tij më të mëdha dhe këtë e tregon qartazi me pasionin e tij ndaj punës që ai bën. Jo më larg se 15 dhjetori i vitit të shkuar, Xhani Shqerrës nisi një rrugëtim të ri në media me një emision krejt të tijin të quajtur “Bel Mondo”, emisioni i cili u mirëprit shumë nga publiku i gjerë. Por, për të njohur më tepër lidhur me pasionet e tij, risitë që sjell në këtë emision si dhe pak elementë pikantë të pashprehur më parë lidhur me largimin e tij, Xhani vjen në një rrëfim ekskluziv për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”.

**Pothuajse gjithnjë pas Vitit të Ri, njerëzit kërkojnë sërish pushime e qetësi. Si e ka pritur 2019-ën Xhani? Cila ishte e veçanta e këtij viti të ri?**

Në fakt, pjesën e pushimeve e kam shijuar shumë, sepse është i vetmi moment kur mund të qëndroj pranë familjes, duke pasur një vit shumë të ngjeshur me punë dhe impenjime. Do doja që edhe në 2019-ën të kisha më shumë kohë për familjen për të qëndruar pranë të

“Dua që 2019-ta të jetë viti ku të gjej dashurinë”



dashurve të mi.

**Çfarë i keni premtuar vetes për këtë Vit të Ri? Çfarë do të bëjë ndryshe Xhani?**

Do doja që këtë vit të kisha pak më shumë kohë për veten, të merresha më tepër me sferën personale, intime dhe jo vetëm punë. Edhe pse pjesa e punës sime është shumë e bukur, e veçantë e më kompletan në gjithçka që unë jam dhe bëj. Por gjithsesi, është momenti për t’iu dedikuar pak më shumë

pjesës më personale.

**Nga çfarë “vesi” do të hiqni dorë?**

Do të më pëlqente që më tepër se ves, të filloja palestrenë e të më shndërrohej në një “ves”. Duke qenë se nuk kam marrëdhënie të mira me aktivitetet fizike, do të më pëlqente që ky të ishte viti i duhur për t’i thërritur pak mendjes për të bërë pak kulturizëm, e të shndërrohet në një “ves”, pse jo.

**Vetëm 1 muaj më parë nisët emisionin tuaj më të**

**ri. Si lindi ideja e emrit dhe formatit?**

Formati vjen si një rezultat i një pune shumëvjeçare. Unë e kisha të nevojshme të shprehesh në raport me median në një mënyrë më të madhe, më të fortë e më prezente për gjërat që bëj. Titulli ka ardhur shumë natyrisht. Duke qenë se unë rrethohem gjithmonë nga e bukura, kam dashur që nëpërmjet medias dhe ekranit të përçoj vlerat për një botë të bukur, për një botë pozitive, me njerëz që e zbukurojnë jetën e tyre dhe që kanë një qasje pozitive. Të gjitha këto vlera jam munduar që t’i sjell me anë të rubrikës dhe me takimin që tashmë është javor në “Klan Plus”.



**Sa i lidhur është Xhani me median?**

Median dhe ekranin e shoh si një mundësi shumë të mirë për të shprehur vizionin tim dhe për të përmbledhur pasionet, duke pasur një qasje me publikun shumë reale, optimiste dhe të vërtetë. Do doja që misioni i medias të ishte kultura, informimi, zbatimja, por me anë të vlerave të vërteta. Kështu që nuk do të bëja kompromise për asnjë arsye për të rrëzuar apo modifikuar këto vlera, por do të më pëlqente që t’i pasuroja nëpërmjet impenjimeve që do të kem jo vetëm me këtë

format, por me gjithçka kam bërë dhe do të bëj në raport me median.

**Cila do të ishte shuma që do t’ju joshite më tepër për t’u larguar nga ekranit?**

Nuk ka të bëjë me shumat, por ka të bëjë me qasjen që unë kam ndaj të punuarit, të vepruarit. Kam përshtypjen se është çështje fazash. Ndonëse unë e kam nisur shumë i vogël me median dhe jam rithyer më pas dhe si i rritur, mendoj që të komunikuarit me anë të ekranit është një mënyrë shumë e mirë për të komunikuar vlera që janë në dobi të shoqërisë. Por duke thënë këtë, jam edhe i bindur që nuk do të jem në ekran në plan të parë gjatë gjithë kohës. Më pëlqen edhe pjesa e organizimit, e të qenurit në “backstage”, me “Bel Mondo-n” e bëj gjithashtu. Jam i impenjuar jo vetëm me pjesën e autorësisë, por edhe





regjisë. Sigurisht që është çështje fazash dhe dua të bëj atë që më jep më shumë pasion, dëshirë dhe dashuri dhe dua që realisht gjithçka që të bëj të jetë e bindshme e të jetë fryti i një pasioni dhe dashurie për atë që po bëj.

**Këngëtar, model, moderator, drejtor arti, ku e jeni veten më mirë Xhani?**

Modelit i ka humbur boja, ka shumë vite (qesh), dhe këngëtarit gjithashtu, ndonëse këndoj në rrethe shoqërore për kënaqësinë e gjësë. Por pjesën e ekranit, të moderimit dhe të drejtimit të realiteteve artistike sigurisht që është më prezente tek unë, sepse janë pjekur edhe shumë përvoja, më pëlqen ta shoh veten në këtë këndvështrim. Uroj që në të ardhmen unë të jem një model i mirë për këto dy të fundit: moderimit dhe realizimit të situatave artistike.

**Keni ndonjë plan që t'i riktheheni muzikës me ndonjë këngë të re?**

I vetmi plan lidhur me muzikën do të ishte ndonjë pjesëmarrje në spektakle ku ka edhe një qasje kënge, por jo më shumë. Me klipe apo me ndonjë këngë të re, nuk besoj, jam i fokusuar tek moderimi.

**Ka qenë vërtetë rroga, arsyeja e largimit nga "Tring", apo ndonjë mosmarrëveshje e pashprehur?**

Në fakt, arsyeja e largimit nuk ka qenë asnjëra prej këtyre të dyjave. Ka ardhur si rezultat i një pjekurie të përvojave. Besoj se është mëse normale kur aspiron të kesh diçka më të madhe, diçka ndryshe dhe ta glesh në një vend tjetër, që s'është më ajo shtëpi. Është mëse normale që ti pas disa viteve që ke jetuar në një shtëpi, të kërkosësh sipërfaqe më të madhe dhe nga dy dhoma e një kuzhinë, mbase të marrësh edhe një apartament tjetër që të ketë dhe verandën mundësisht apo një kuzhinë pak më të madhe për t'u shprehur, për të qëndruar mirë. Bëra këtë paralelizëm sepse unë "Tring"-un e kam konsideruar dhe vazhdoj ta konsideroj shtëpinë time të parë. Do ta kujtoj me shumë respekt dhe kam një marrëdhënie shumë të mirë ende sot me ish-kolegët e mi, por siç e bëra me dije në fund të sezonit të gjashtë të "My Living", pritej që unë të bëja një hap tjetër, që më pas edhe e ndërruam sepse e ndjeja të nevojshme. "Tring" më ka dhënë gjithçka, por ishte gjithçka që mund të më jepte. Ndërkohë unë jam rritur pak

edhe nga përvoja dhe në kontakt me publikun do të doja që të kisha një qasje në vetë të parë si autor dhe prezantues. Këto gjëra i bëja edhe në "Living", por kisha nevojë të shpreheshmë më shumë dhe kjo ishte arsyeja.

**Ç'mendim keni që vendin tuaj në "Tring" e zuri Arjoni? Ju kë do të zgjidhnit?**

Vendet nuk janë të përjetshme. Sigurisht që jo vetëm unë, por kushdo tjetër nuk është i pazëvendësueshëm, por në të njëjtën kohë nuk mund të zëvendësohet një emër. Secili sjell nga vetja diç-




ka dhe pikërisht me qasjen e Arjonit në "Tring", unë kam qenë një nga promotorët më të mëdhenj, në mos i pari, pikërisht për ardhjen e tij në formate të ndryshme. Një ka qenë dhe "Shopping Night", ku unë doja që ai të ishte prezantues sepse në atë format unë isha autori dhe kisha mundësi si përzgjedhjeje për sa i përket moderimit. Kështu që mund të themi që unë kam qenë një partner shumë i mirë i tij për ardhjen në Tring. Jo për "My Living", nuk ishte ideja ime, por mendoj që

është një prezantues shumë i mirë dhe ka vendin e vet në çdo gjë që bëm. Unë i uroj një rrugëtim të mbarë në "My Living" dhe kam përshtypjen që me kalimin e kohës ai do të gjejë veten në një format shumë të bukur dhe në "Tring".

**Lidhur me jetën private jeni treguar shumë diskret. Mund ta përmbledhni me disa fjalë tipin e personit që ju ka rrëmbyer zemrën?**

Nuk kam çfarë të them për jetën private në fakt. U bë shumë kohë që unë fokusohem tek profesioni im dhe tek hapësira që më duhet që të zë gjatë gjithë kohës dhe fatkeqësisht nuk e kam një njeri të zemrës, por uroj që në këtë vit të ri, siç thash, të kam pak më shumë fokus ndaj vetes. Sigurisht, dashuria dhe një vajzë me ato kriteret që çdo mashkull mund të ëndërron për veten, mund t'i bashkohet dhe pse jo të rrugëtojmë së bashku, ku



secili në pjesën e vet të japë më të mirën e të ndjehet i realizuar, i dashuruar kur pranë ka një mbështetëse apo mbështetës të mirë. Është e vetmja gjë që uroj këtë vit, është e vetmja gjë që më mungon. Janë të hapura seleksionimet. (qesh)

**Cili është thashethemi më absurd që ka ndikuar negativisht tek ju? Si keni reaguar?**

Për njerëzit publikë thashethemet janë nga më të ndryshmet. Unë jam mësuar që i vogël të mos kem veshë jo vetëm ndaj gjërave që mund të jenë të papjekura apo banale. Realisht nuk kanë influencuar tek unë asnjëherë, as për të mirë e as për të keq, jo vetëm thashetheme me karakter negativ, por as thashetheme me gjëra që mund të jenë më pozitive, apo që mund të të bëjnë të buzëqeshësh, nuk kanë ndikuar asnjëherë. Është pjesë e paketës. Do ketë njerëz që të shohin në një mënyrë, disa në një mënyrë tjetër, por kjo s'do të thotë që të kesh një konsideratë të vetes

me sytë e të tjerëve. Do më pëlqente që njerëzit të më shihnin me sytë e mi, por kjo është e pamundur, sepse edhe unë veten e shoh ndryshe nga dita në ditë, kështu që mbetet diçka utopike. Por më vjen mirë që

pjesa më e madhe kanë një vlerësim për gjërat që unë bëj me vërtetësi. Kështu që për një artist, apo njeri të medias kjo është shumë e rëndësishme, kështu që unë e ndiej veten shumë me fat!

Opinion *i* Ditës

# Jepini fund këtij turpi!

Nga Zef Mazi

(vijon nga faqja 1)

...si zvmnistër. Këto orë për të po thuhet se paska njohuri të admirueshme, pavarësisht nga mosha. Kjo tregon në fakt metrin e gjykimit dhe standardin e vlerësimit të të emëruarve në shtetin e sotëm shqiptar. Del e qartë kësaj sesi u bëkan vlerësimet dhe si arrihet në konkluzione mbi karrierat dhe nivelin profesional të të emëruarve, që të habisin për mendjelehtësinë që bartin!

Kryeministri Rama ka hyrë në konflikt publik me Presidentin e Republikës për kandidaturën e ministrit në fjalë, duke spostuar njëkohësisht edhe ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati, i cili ende është në detyrë. Nga ana e tij, edhe Presidenti duket se po luan politikisht.

Mendoj se kjo situatë, kështu siç shihet e gjykohet në momentin aktual, nuk shkon në drejtim të interesave të mëdha të vendit, si në rrafshin politik e kombëtar, ashtu edhe në atë global.

Nuk po zgjatem, por shënoj se kjo që ka ndodhur e që vijon të konsumohet, tregon qartë sesa i papjekur është vendi ynë, sesa joseriozë janë politikanët shqiptarë, sesa i cekët është gjykimi i tyre dhe sa të kënaqur duhet të ndjehen sot disa fqinjë që sodisin maskaradën tonë të radhës.

Ministria e Jashtme është nga institucionet më të rëndësishme të vendit. Me të nuk mund të bëhen lojëra dhe akrobaci, apo lajthitje si ato që vihen re tek ne. Ky institucion është pasqyra e vendit në arenën ndërkombëtare! Serioziteti i tij reflektohet pike së pari që nga titullari i ministrit dhe më pas zbrit poshtë te drejtorët, ambasadorët e kështu me radhë.

Është shumë zor sot të gjej një vend që të ketë për ministër të Jashtëm një djalosh kaq të ri dhe pa përvojë, ose me përvojë mjerisht minimale. Rasti i veçantë i Austrisë që po citohet lart e poshtë ishte thjesht një përjashtim, por shënojmë se ish-ministri i Jashtëm, sot kryeministër, kishte mbi 15 vjet karrierë në partinë e tij politike, ishte rritur dhe ngritur atje, dhe gjeti dhe la një staf ministrie tepër serioz dhe me përvojë mjaft të gjatë, që e udhëzonte rregullisht.

Shkolla e kryer, diku edhe kjo duhet parë me kujdes, kur është puna për poste të tilla, të mëson sesi dhe ku duhen hapur librat, ajo të mëson edhe se cili libër duhet



Ministria e Jashtme është nga institucionet më të rëndësishme të vendit. Me të nuk mund të bëhen lojëra dhe akrobaci, apo lajthitje si ato që vihen re tek ne. Ky institucion është pasqyra e vendit në arenën ndërkombëtare! Serioziteti i tij reflektohet pike së pari që nga titullari i ministrit dhe më pas zbrit poshtë te drejtorët, ambasadorët e kështu me radhë.

Është shumë zor sot të gjej një vend që të ketë për ministër të Jashtëm një djalosh kaq të ri dhe pa përvojë, ose me përvojë mjerisht minimale. Rasti i veçantë i Austrisë që po citohet lart e poshtë ishte thjesht një përjashtim, por shënojmë se ish-ministri i Jashtëm, sot kryeministër, kishte mbi 15 vjet karrierë në partinë e tij politike, ishte rritur dhe ngritur atje, dhe gjeti dhe la një staf ministrie tepër serioz dhe me përvojë mjaft të gjatë, që e udhëzonte rregullisht.

hapur e konsultuar në cilën periudhë, etj. Por, shkolla nuk është etaloni i vetëm kutmatës! Përvoja është puna, puna dhe vetëm puna, eksperiencia në diplomacinë e aplikuar, ku kalohen e hipen të gjitha

shkallët profesionale, gradualisht dhe një nga një. Parashutimet e menjëhershme janë mjaft të rrezikshme për një shtet serioz (mirëpo një shtet serioz nuk bën ato që bëjmë ne në Shqipëri...). Vendi ynë

nuk e ka luksin për të tilla situata joserioze.

Ky rast ekstrem duhet të bëjë që të reflektohet dhe jo të shahet, të rivendosen ekuilibrat dhe të jepen zgjidhje me një ministër

tjetër, në moshë të respektuar, me njohuri, përvojë dhe zgjuarsia politike dhe diplomatike! A nuk ka vallë një njeri të tillë e gjithë struktura e Partisë Socialiste? Po ajo e opozitës vallë nuk ka? Po OJQ-të, apo shoqëria civile nuk paskan një të tillë? Me siguri që po, por duhet menduar thellë!

Shqipëria, si thamë më lart, nuk i ka disa lukse si të tjerët. Ne jemi vend i vogël, gabime mund të bëhen lehtë dhe ato lënë pasojë jo të vogla. Ne duhet të bëjmë shumë herë më tepër kujdes që të jemi të respektuar, të dëgjuar, të pranuar me ndërgjegje dhe të zgjuar.

Mjafton të përmend këtu kryesinë e radhës të OSBE-së, që ne e marrim vitin e ardhshëm. Nga përvoja e gatë e di mirë që duhet të ndalesh e të mendosh thellë: cili do jetë ministri i Jashtëm i yni dhe me çfarë bagazhi, moshe dhe përvojë do të vijë ai? Cili rast nuk krijon çekuilibra edhe të përmasave rajonale, vështrime vëngër, etj., me cilin ministër kryesia do të shkojë në të gjitha pikat e tensionuara apo konfliktuale të zonës së OSBE dhe do të bisedojë me pushtetarët, të zgjedhur ose jo, me parlamentarët, me OJQ-të vendore, me misionet e OSBE-se, me shoqërinë civile, me palët në konflikt etj.

Sa do të jetë ky ministër në gjendje të japë udhëzime dhe ide sesi duhet të bëhet kjo ose ajo gjë, si duhet të ndiqet ky ose ai proces, ç'drejtim duhet të marrin teza dhe propozime të caktuara, që ato të jenë të duartroktitura dhe të pranueshme për të gjithë! Me cilin ministër do të bisedojnë homologët e Evropës dhe më gjerë, me cilin ministër do të shkëmbejnë ata mendime të pjekura, të thella në përvojë dhe nga cili ministër, kryetar radhe, ata do të marrin udhëzime?

Është nevojë urgjente që këto aspekte, të gjitha e paneglizhuar as edhe një prej tyre, të mendohen thellë dhe të arrihet në konkluzione dhe gjetje të forta, të qëndrueshme, të rregullta dhe të respektueshme e të pranuar nga të gjithë. Këtë ta mëson përvoja e gjatë, këtë ne, Shqipëria, nuk kemi luksin ta anashkalojmë apo, edhe më keq, ta injorojmë. Sharjet, hedhja e fajit sa këtëj, sa andej, këmbënguljet foshnjore etj., nuk ndihmojnë aspak.

Ai që di të falë dhe të thotë "u bë një gabim, hajde ta korrigjojmë bashkërisht, të shohim dhe të ecim përpara" - ai tregohet i lartë. Nuk është turp, përkundrazi, bën mirë, është në të mirën e vendit.

\*Autori është diplomat i vjetër, ai ka qenë ambasador i Shqipërisë në Austri, OKB, OSBE, Angli, si dhe ka qenë për shtatë vjet Asistent Special i Drejtorit të Përgjithshëm të IAEA për Strategjinë.



**BLUE TOOTH**

THASHETHEME MADE IN ALBANIA



te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me



Dje në 'Deutsche Welle'

# Meta-Bushati kundër ndryshimit të kufijve

Nga Ani Ruci

(vijon nga faqja 1)

...Ilir Meta për të dekretuar ministër të Jashtëm të Shqipërisë, Gent Cakaj nga Prishtina, të propozuar nga kryeministri Edi Rama për këtë post, pas ndryshimeve të thella në qeverinë e tij, dy javë më parë, që përfshinë edhe largimin e ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati.

Presidenti Meta e argumentoi refuzimin me profilin e 28 vjeçarit nga Kosova, Gent Cakaj. Për Metën: "Gent Cakaj ka mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative, shtetërore, në secilin element dhe në tërësi". Për të argumentuar profilin 'e papërshtatshëm' të Gent Cakajt, presidenti i referohet disa deklaratave të dhëna nga Cakaj vitin e kaluar, në një emision televiziv: "për shkëmbimin e territoreve apo korrigjimin e kufijve mes Serbisë dhe Kosovës". Meta citon Cakajin të ketë thënë se "shkëmbimi i kufijve po konceptohet në suaza të korrigjimeve të përgjithshme territoriale që janë duke ndodhur në Ballkanin Perëndimor". Një argument tjetër është moskryerja nga Gent Cakaj, e detyrimit ligjor për marrjen e Certifikatës së Sigurisë, kur në qershor 2018, nga këshilltar i kryeministrit Rama ai u emërua z.v. ministër i Jashtëm, gjë që për Presidentin Meta "përbën shkelje penale, të dënueshme sipas legjislacionit në fuqi që jo vetëm ka vënë në rrezik informacionin e klasifikuar sekret shtetëror apo sekret NATO dhe BE, por nga ana tjetër ai ka shfaqur hapazi mosbindjen e tij përballë një detyrimi të qartë ligjor".

## Kriza institucionale në Shqipëri dhe marrëveshja Kosovë-Serbi

Arben Cici, Drejtor i Kabinetit të Presidentit Meta, në një deklaratë për një kanal televiziv në Tiranë, komentoi qëndrimin e mësipërm publik të Presidentit Meta për deklaratat e z. Cakaj lidhur me ndryshimin e kufijve Kosovë-Serbi. "Intervista e z. Cakaj, në nëntor të vitit të kaluar, ka shumë qëndrime ambigue, sidomos kur bëhet fjalë për politikën e jashtme rajonale dhe çështjen e kufijve, shkëmbime ose korrigjime territoriale që shkojnë ndesh, si me parimet e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe me vetë programin e qeverisë shqiptare si edhe politikën e NATO-së, BE-së në qasjen e tyre rajonale."

Kryeministri Rama e quajti të turpshëm refuzimin e Presidentit Meta dhe i kërkoi madje ndjesë Kosovës. Presidenti Meta reagoi duke thënë, se "integriteti territorial dhe pavarësia e Kosovës janë të paprekshme". Të premtën, (11.01.) kriza me presidencën dhe kryeministrinë u thellua, pothuajse "in extremis" përmes postimeve në rrjetet sociale nga të dyja palët. Presidenti Meta shkruan (11.01) në median sociale se kryeministri Rama "bëri gabimin fatal të kërcënojë edhe



Presidentin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të drejtpërdrejtë". Në priten me trupin diplomatik të akredituar në Shqipëri, të enjten (10.01.) Rama e quajti refuzimin e dekretimit të Gent Cakajt "avaz të vjetër të Presidentit të Republikës".

Irii 28 vjeçar nga Prishtina Gent Cakaj është kthyer në personazhin e ditës në Tiranë. Duket se është shndërruar edhe në një "casus belli" për shpërthimin publik të shkaktuar të krizës institucionale në Shqipëri mes Presidencës dhe Kryeministrisë, pas daljes në pah

të refuzimit.

Duket se shkak real është qëndrimin i ndryshëm i presidentit Meta dhe Ministrit të jashtëm Bushati, ndaj mundësisë për të normalizuar marrëdhëniet Kosovë-Serbi përmes ndryshimit të kufijve. Presidenti Meta dhe ministri Bushati nuk e mbështesin këtë opsion, duke qenë kështu në të njëjtën linjë me qëndrimin zyrtar të Gjermanisë. Kryeministri Rama ka evituar të deklarojë qëndrimin e tij, duke lënë të kuptohet që mund edhe të mos e përjashtojë si opsion. Si Meta edhe Bushati kanë shprehur në mënyrë konsekuente idenë, se ndryshim i kufijve sjell rreziqe për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon.

"Nuk ka fuqi në botë t'i bëjë presion e shantazh Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Nuk ka Gjykatë Kushtetuese në botë që ndalon e interpreton kompetencat që i jep Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë presidentit për emërimin e shkarkimin e ministrave e në veçanti të atyre që janë anëtarë të Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Interesi kombëtar i pari! Shqipëria e Para! shkruan të premtën në 'Facebook', presidenti Ilir Meta.

Arben Cici, drejtor i Kabinetit të Presidentit Meta, në një deklaratë për një kanal televiziv në Tiranë, komentoi qëndrimin e mësipërm publik të Presidentit Meta për deklaratat e z. Cakaj lidhur me ndryshimin e kufijve Kosovë-Serbi. "Intervista e z. Cakaj, në nëntor të vitit të kaluar, ka shumë qëndrime ambigue, sidomos kur bëhet fjalë për politikën e jashtme rajonale dhe çështjen e kufijve, shkëmbime ose korrigjime territoriale që shkojnë ndesh, si me parimet e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe me vetë programin e qeverisë shqiptare si edhe politikën e NATO-së, BE-së në qasjen e tyre rajonale."

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Përpunimi të shmagani nga vetja njerëz, të cilët kujdesen vetëm për paraqitjen e jashtme. Nëse qëndroni në praninë e këtyre njerëzve, disa persona me ndikim mund të krijoni mendimin e gabuar rreth jush. Duke mbrojtur vlerat tuaja, ju, në fakt, i përforconi ato.

**DEMI**  
Është koha për t'u treguar më konservatore dhe për t'i bërë gjërat më ngadalë. Nëse do të keni një lidhje të re dashurie apo një propozim të ri për punë, diçka emocionuese po vjen drejt jush. Provojeni ujin me majat e gishtave të këmbës, përpara se të zhyteni në ujë.

**BINJAKET**  
Idetë tuaja janë padyshim ato më të mirat që ofrohen sot, por si është e mundur që askush nuk po ju dëgjon? Nuk është momenti për t'u përfshirë nga zemërimi, sepse kështu njerëzit nuk do t'ju marrin seriozisht. Në situatat e grupit, ndonjëherë përgjigja më e mirë nuk është përgjigja e duhur, është përgjigja për të cilën bien të gjithë dakord.

**GAFORJA**  
Marrëdhënia juaj tashmë e komplikuar me paratë po bëhet gjithnjë e më komplekse. Linja e fundit është ende e njëjtë - nuk duhet të shpenzoni më shumë se sa keni, dhe duhet të kurseni më shumë se sa keni nevojë. Mendoni në mënyrë konservatore dhe kujdesuni për portofolin tuaj.

**LUANI**  
A është krenaria ajo që po ju lë në një qoshe? Nuk është kurrë tepër vonë për të pranuar se nuk mund të dish gjithçka, prandaj nëse ndihesh në panik për të mbajtur një premtim që është i pamundur të mbahet, duhet të flisni hapur. Frika juaj për ndëshkimin është krejtësisht e pajustifikuar.

**VIERGJERESHA**  
Do të ndodhë një ndryshim i madh në rutinën tuaj - dhe mund të jetë shumë e vështirë për ju të mësoheni me këtë. Ky ndryshim mund të mos jetë i përherëshëm, por do të zgjasë për një kohë të gjatë. Kështu që rruga më e sigurt dhe më e mençur për ju është të supozoni se kjo është mënyra e re për t'i bërë gjërat.

**PESHORJA**  
Nëse nuk jeni në gjendjen e duhur për të qenë shororor, atëherë mos jini i tillë kohë e fundit. Keni pasur një tendencë për të sakrifikuar kohën tuaj të lirë sa herë që dikush ju ka kërkuar dhe kjo duhet të ndalet. Është koha për të thënë jo vetëm sepse ju pëlqen.

**AKRËPI**  
Disa njerëz përpunimi të shpërndrojnë veten nga problemet në shtëpi duke u zhytur në punë ose në shkollë. Por kjo taktikë është e varfër, duke qenë se vetëm vonon pashmangshmërinë. Mos bëni gabim duke pretenduar se problemet nuk ekzistojnë.

**SHIGJETARI**  
Ndjeshmëria duhet të jetë pjesë e juaja dhe të qenë veten në një bisedë të vështirë. Ju mund të përmirësoni çdo situatë të tensionuar duke u përpjekur të kuptoni dhe respektoni atë që motivon personin tjetër. Jini shumë të vetëdijshëm për atë që thonë sot.

**BRICJAPI**  
Dikush mund t'ju japë një sugjerim të pafajshëm sot që mund të të zemërojë. Ky person nuk ka si qëllim të lëndojë ndjenjat tuaja. Ai ose ajo vetëm po përpunon të të ndihmojë. Duhet të mendoni dy herë përpara se të dilni në përfundime të gabuara.

**UJORI**  
Jo çdo ditë mund të jetë e shkëlqyer sepse atëherë do t'i merrnit si të mirëqena. Sot ju duhet të synoni për një ditë mesatare dhe shansin janë që të kënaqeni kur dita të përmirësohet ndryshim. Në dashuri mund të ketë një ndryshim që mund t'ju gëzojë ndërsa me paratë tregoni kujdes.

**PESHQIT**  
Është mirë që të keni disiplinë, por nëse i mroni vetes shumë kënaqësi për një kohë të gjatë, rrezikoni të jeni një person i murrizshëm! Pra, jepini vetes një pushim sot, dhe lejoni veten të devijoni pak nga orari juaj i rreptë. Nuk ka gëzim në përkujtimin për të qenë e përsosur.

## Të kuqtë dhe verilindorët siglojë shifrat 1-1

### Partizani dhe Kukësi barazojnë në miqësoret në Antalia

Partizani ka arritur që të marrë një tjetër barazim në miqësoren e dytë në Turqi, kësaj here kundër ekipit turk, Antaliaspor. Të besuarit e Gegës, që kishte vendosur të hidhte nga minuta e parë formacionin rezervë, e panë veten në disavantazh që në minutën e 2-të,



kur Sinik befasoi portierin Xhika. Pjesa e parë është mbyllur me shifrat 1 me 0. Me startin e pjesës së dytë, Gega ka rreshtuar formacionin tip dhe ekipi i "Demave" është hedhur menjëherë në sulm, duke u treguar mjaft agresiv. Ata kanë arritur që

të gjejnë rrugën e rrjetës në minutën e 46-të me anë të Jurgen Bardhit. Një ndeshje e rëndësishme kjo për Gegën, ku nuk ka lënë pa provuar thujtë të gjithë lojtarët dhe ky ka qenë një test shumë i mirë kundër një kundërshtari të fortë.

Kukësi ka barazuar 1-1 në miqësoren e dytë në tokën turke, ku përballë kishte rusët e Rostovit. Pas humbjes 2-1 ndaj Bashakshehirit, verilindorët kanë marrë një rezultat pozitiv. Goli i barazimit u shënua nga Çyrbja në fundin e pjesës

së parë, pasi rusët kishin shënuar me Gulevskin. Futbollisti shijakas shënoi edhe në humbjen 2-1 me Bashakshehirin. Trajneri Armando Cungu kishte bërë disa ndryshime në krahasim me ndeshjen e fundit ndaj Bashakshehirit. Titullar në sulm ishte Vasil Shkurtaj, që la në stol Rexhinaldon. Titullar luajti edhe mbrojtësi Rrumbullaku, ndërkohë që Ethem i nisi nga stoli në mesfushë.

Presidenti i verilindorëve vlerëson ardhjen e Shkurtajt e Rrocës dhe premtion blerje të tjera

# Gjici: Kukësi im del kampion, stadiumin po e pengon bashkia

## Qeveria ka miratuar fondin, por punimet nuk po nisnin



Jeton Selimi

Safet Gjici, në 360 gradë. Presidenti i skuadrës së Kukësit rrëfen sezonin e Kukësit të tij. Në një rrëfim për "RTSH Sport", kreu i skuadrës verilindore komenton merkaton e bërë si dhe gjendjen e ekipit. Madje, rrëfen edhe vështirësitë për të luajtur jashtë, ndërsa tregon se punimet për stadiumin e ri ende nuk kanë nisur, pasi Bashkia Kukësi po bëhet pengesë. Gjithashtu, Gjici deklaroi se në fund të sezonit shihet kampion ekipin e tij, pavarësisht garës së fortë për titullin.

### EKIPI

"Kemi bërë ca lëvizje, besoj se janë disa lëvizje që janë të rëndësishme për kampionatin shqiptar, por me përforsimet që kemi bërë realisht të Kukësi, skuadra e ka marrë formën dhe jemi në rrugën e duhur për objektivin e vendosur në fillim të sezonit, titullin kampion. Dy fazat e para kanë qenë të mira, por duhet të ishim në vend të parë, na kanë penalizuar të gjitha ndeshjet jashtë, por jemi të kënaqur me ato që kemi arritur. Nëse do të luanim brenda, do të ishim në vend të parë me diferencë pikësh madje".

### MERKATO

"Kam besim shumë, sepse



©F.K.

të dy lojtarët që kanë ardhur janë lojtarë të mirë dhe të njohur. Janë futbollistë që kanë bërë shumë mirë dhe shpresoj të ambientohen shpejt me ekipin. Faza përgatitore është koha e përshtatshme që ata të njihen me

ekipin dhe besoj se do të ecin. Kam besim tek ata, pasi janë në kulmin e karrierës së tyre dhe nuk janë 20 vjeç dhe po iu jep kohë. Ju e dini se në futboll ndodh gjithçka, por ato kërkesa që ka pasur stafi teknik dhe trajneri, ne

jemi munduar t'i plotësojmë të gjitha. Tani i kanë kualitet për të arritur të titullin kampion. Menaxherët kanë disa lojtarë në mendje për të afruar dhe po diskutojnë me trajnerin. Po shyrtojnë të gjitha alternativat dhe ndoshta do të vijë një mesfushor që do të bëjë diferencën, ose ndonjë mbrojtës që mund të mbulojë të gjithë repartin e prapavijës. Kështu që ndoshta 1-2 futbollistë mund t'i afrojmë, por vetëm nëse bëjnë diferencën.

### ZGJEDHJET

"Njëherë, ju e dini që qeveria ka miratuar fondin së bashku me federatën. Kuptohet që Bashkia e Kukësit jo vetëm që nuk e ka ndihmuar ekipin e Kukësit, por nuk paguan asnjë lekë, pavarësisht se ka aksione. Ky nuk është problemi më i madh, por krijon edhe pengesa. Atje shkojnë inxhinierët dhe bëjnë matjet

dhe gjërat e duhura për të bërë stadiumin, por pengohen për arsye politike, thua t'i ndalova unë ta bënin stadiumin kur ishte Berisha. Nëse unë do të bëhem kryetar bashkie, Kukësin do të marrë dikush tjetër. Por kjo nuk do të thotë që ne si bashki nuk do e mbështesim Kukësin, madje do të bëjmë pamundurën që skuadra të shkojë minimalisht në fazën e grupeve në kompeticionet evropiane. Unë e dua Kukësin dhe e dua futbollin, pasi futboli mban lart vlerat e kuksianëve".

### STADIUMI

"Kemi bërë një marrëveshje me Kamzën dhe shumicën e ndeshjeve do t'i luajmë aty, vetëm në ndonjë përplasje kalendari. Besoj se edhe fusha e Kamzës do të jetë optimale. Ne kemi bërë një marrëveshje, falënderoj Bashkinë e Kamzës që arritëm të gjejmë një marrëveshje".

### TITULLI

"Janë shumë ekipe që duan titullin kampion dhe që do të ndeshen deri në fund. Partizani, Kukësi, Teuta dhe Skënderbeu, që nuk largohet asnjëherë nga lufta për titull. Favorit? Vetëm Kukësi. Kukësi, Kukësi dhe vetëm Kukësi. Po bëjmë investimet më të mëdha se të gjitha skuadrat tjera dhe ne e meritojmë të jemi kampionë. Unë nuk gëzohem asnjëherë kur dënohet një ekip kundërshtar dhe ato presidentë që i gëzohen këtij fakti, unë nuk i kam kolegë".

### ARBITRAT

"Ka gjithmonë gabime, por dua të them se këtë sezon, gabimet kanë qenë më të pakta. Ka disa ekipe që duan të dalin kampionë me forma të tjera, por nuk mendoj se do të ketë favorizime. Besoj se kush del kampion, do e meritojë plotësisht. Çdo skuadër në këto 7 vitet e fundit ka marrë hakun që i takon".

## Trajneri i kuq, i kënaqur me paraqitjen

### Gega: Do të kthehemi në Tiranë me 100% të formës

shikonim çdo lojtar. Na munguan sërish Hebab dhe Duka, për probleme shëndetësore, por besoj se ata do të jenë gati për miqësoren e tretë. Besoj se jemi mirë, po zhvillohet një stërvitje e rregullt, nuk kemi probleme fizike. Dua që të kthehemi në Tiranë me 100% të kapacitetit tonë si ekip dhe me një frymë edhe më optimiste. Në ndeshjen e parë u ndëshkuam nga një penallti, ndoshta e pagëna, ndërsa sot pësuam një gol që në minutën e dytë për mungesë përvojë.

Pjesa e dytë ishte shumë e mirë, ishin 25 minuta lojë që nuk i kisha parë. Mënyra si erdhi loja në këtë ndeshje, jam i kënaqur. Kushet këtu janë të mira, fushat janë të mira. E dimë se çfarë qëllimi dhe çfarë objektivit kemi për vazhdimin e sezonit. Çdo ndeshje është një test për çdo lojtar. Me Dinamon e Zagrebit do të shohim vlerat tona, edhe pse nuk janë rezultatet ato që kanë rëndësi në këto ndeshje", - tha mes të tjerash trajneri i Partizanit.

## Ish-presidenti mbështet sulmuesin

### Morati: Ikardi ka të drejtë të kërkojë rritje rroge


Masimo Morati ka folur për zërat që janë përhapur kohët e fundit lidhur me çështjen e Ikardit dhe Interit. Në një intervistë të shkurtër të dhënë për gazetën italiane "Sport Mediaset", ish-presidenti i Interit ka thënë se klubi zikaltër e ka një strategji si të mbajë sulmuesin argjentinas në ekip. Ai mendon se Ikardi ka shumë të drejtë që të kërkojë rritjen e pagës në rinovimin e tij të kontratës. "Vit për vit dëg-



jojmë zëra lidhur me rinovimin e tij. Mendoj se sulmuesi ka të drejtën që të kërkojë një kontratë më të mirë, por gjithashtu besoj se klubi ka bërë gati strategjinë që ta mbajë në "San Siro". "A do t'i kisha dhënë unë 8-9 milionë euro Ikardit nëse do të isha presidenti? Nuk di si të lidh figurat e të tashmes me ato që kanë qenë në të kaluarën", - ka thënë shkurtimisht Morati.



### Fjalëkryqi (1)



**HORIZONTAL**

1. Humanisti i Rotterdemit
6. Mund të jenë cigaresh.
12. Capirossi i MotoGP.
13. Eshhtë bixhoz
14. I vetmi në orar.
15. Para Diego në Kaliforni.
16. Fillojnë sefte.
17. Eshhtë makina për guidë.
21. Inicialet e Benigni-t.
23. Janë riparime.
25. Janë të brishtë.
27. Fillojnë largimin.
28. Ishin kambistë të dikurshëm.
29. Një motoskaf gaje.
31. Kështu thirrje Marco Pantani.
32. Janë penjtë për moline.
33. Emër vajze.
35. Janë edhe ato të cirkut.
36. Nuk ka tradhtari.

37. Janë baballarët.
38. Fillojnë titrat.
39. Ai dhe ajo.
40. Mbledhë baskët separatistë.
41. Fillojnë saldimit.
42. Gjysma e krahut.
45. Në krye të armatës.
46. Gjysmë krisme.
47. Jepet për hartim.

**VERTIKAL**

1. Paul që qe poet i famshëm.
2. Dennis i McLaren.
3. Këndohet në opera.
4. Gjysmë siklet.
5. Kufijtë e matjes.
6. I zhvillon kongresi.
7. Inicialet e Moravia-s.
8. Janë krerë bandash.
9. Të fundit në tender.

10. Fund shkurti.
11. Mund të jenë grosistë
13. Ka shirit magnetik një e tillë.
15. Ishin engjëj të korit të lartë
17. Janë gjynahet
18. Bega komik.
19. Janë shemra.
20. Inicialet e Morricone-s.
22. Janë edhe ato fetare.
23. Një gjuajtës francez.
24. Gjika e Dora D'Istria-s.
26. Qytet grek.
29. Bëjnë katrorë me një kat.
30. Ishin ndjekësit e Antistenit.
32. Shkruhet i treti.
34. Një sulm... kardiak.
36. Ki Moon i OKB
40. Inicialet e Rohmer.
43. Robert Mitchum.
44. Dy asa.


### Fjalëkryqi (2)

**HORIZONTAL**


1. Bëhet një me psonisje.
5. Një mund të jetë qeveritar
11. Maiden që këndojnë.
13. Një ushtarak është solemn.
15. Inicialet e Mann shkrimtar nobelist.
16. Teket pa kufij.
18. Mbetet në fund.
19. Një treshe në skenë.
21. Një mongol i Timurlengut
23. Një peshk i rëndë.
25. Triac ish-tenist
26. Kufizojnë një takim.
27. U hodhën në Tartar nga Zeusi
30. Fillojnë nazet
31. Kalimi në krye.
32. Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi Jezusit.
34. Janë portet.
35. Dashi kur mungon ai
37. Javier, shefi i diplomacisë së BE
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europeane.

**VERTIKAL**


40. Një birra.
41. Mbetur në fund.
42. Ramazzotti këngëtar
43. Janë në modë.
44. Janë tek në shaka.
45. Eshhtë dite në mbledhje.
47. Një pjesë e kandidaturave.
49. Jessica Parker aktore.
50. Inicialet e Presley.
51. Akoma është ndryshe.
52. Janë brinjët në skuadër.
53. Qendër fitimi
8. Inicialet e Turgeniev.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Mund të lakohet.
12. Janë araknidet si vejshua e zezë.
14. Mund të jetë e lirë në port.
17. Një mjet lundimi.
20. Shkroi Rinoceronti.
22. Ekstremit në ritëm.
24. Kalohen në gjumë.
28. Filmi i parë shqiptar.
29. Fillojnë takimet
31. Kufizojnë kënde.
32. Një depozitë drithi.
33. Janë vendet e para.
34. Një parabolë e tenisit.
36. Eshhtë llogari që qërohet.
37. Shteti me Khartum.
38. Janë kapot e bandave.
41. Lidhin brigje.
42. Një lidhëz
46. King Cole i muzikës.
48. Fillojnë ndeshjen.
49. Sapo fillojnë.
50. Mbetet në fund.



### Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

A V A T I S A L A M I N A  
L A N A F E E A R I S  
A L N E N A P T O P  
N E G E R S I R A T B I  
I T A S M O D E U M I R  
S A M T A R A F F  
M R O N I N A R I E T  
H A B E R I O M A R A  
R I T S E R I T E T  
T E M E B E L I V  
O T M E R I T A S A M  
M A R I A N A A R M A N I

**FJALËKRYQI (2)**

M A R N I E P R M I T E  
I N A T U M A D T E S  
S T U S E N D E R E A  
T E L T U N D I M I A U  
E N K E N D I M I S  
R A A F J O E B E L A  
I T A A N N A K I  
O K A N A I S A R N A  
Z E L L I L I M E D  
T E B A R T I O N T O R  
T O K A L E I N L E R A  
M I N I M A L E S T E R

### SUDOKU

				3	7	1
7		1	5			
		6				
		3	8		2	9
5	9	8		6	7	
3	5		2		9	7
	6	7		4		5
					6	2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	8	7	2	4	9	5	6	1
2	4	1	7	5	6	8	9	3
5	9	6	8	1	3	2	7	4
7	5	2	6	8	4	3	1	9
8	1	3	5	9	7	4	2	6
4	6	9	1	3	2	7	5	8
6	7	8	4	2	1	9	3	5
9	2	5	3	6	8	1	4	7
1	3	4	9	7	5	6	8	2

### Argëtim filozofik

- Zgjoni ata që janë duke fjetur dhe jo ata që ëndërojnë .. !!

- Gjysma e punës është mbaruar kur ajo fillohet me dëshirë.

- Duaje tjetrin sa ka para, pozitë dhe fuqi, kur ti rëshkasë këmba, godite edhe ti .

- Bëjni sytë katër para martesë, dhe mbajni gjysmë mbyllur pas martesë.

- Nëse i detyrohesh bankës 100 dollarë, ky është problemi yt.

### KRIPTOSKEME

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	2	9	4	1	10	5	10	T	E	K	B	O	M	B	R	E	D	H						
2	7	8	6		15	3	6	10	3	O	R	A	T	O	R	E	T	E	S	E				
1	0		8	5	3		9	3	7	9	G	N	O	T	A	R	E	T	T	M	T			
5	K	1		2	3	11	3	4	7	5	8	4	E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
1	A		2	8	11	1	12	8	11	3	13	8	R	S	L	R	E	T	E	R	I	K		
		5	3	6	3	12	8	13	8		1	6	P	E	L	O	T	A	D	V	M	A		
5			11	3	16	3	6		6	6	1	6	S	O	T	R	T	A	R	E	E	T		
1			7	4	3	13	7	3		6			T	R		G	P	A	R	E	T	E		
2	3			8		7	5	1	11	3	4		E	T	L	A	R	I	T	M	I	A		
7	6		4	1	4	3	13	7	4	3	6		F	I	L	I	Z	A	T	E	A	G	A	
11	3	2		16	8	11		9	15	4			A	D	I	T	E	T	T	O	M			
7	4	8	6	8		8	16		8	3	10		N	O	B	I	L	E	B	A	N	A	L	E

### Thënie të mençura

- Nëse i detyrohesh bankës 100 milionë dollarë, atëherë është problemi i bankës.
- Gjithçka që kërkohet është një mundësi për të treguar se paratë nuk më bëjnë të lumtur.
- "Çdo ditë ngrihem dhe shikoj listën e "Forbes" për njerëzit më të pasur. Nëse nuk jam atje, shkoj në punë".
- "Ndryshimi mes një divorci dhe një ndarjeje
- ligjore është se ndarja ligjore i jep burrit kohë për të fshehur paratë e tij"
- "Nëse mendon se askujt nuk i intereson nëse je gjallë, provo të mos paguash dy muaj fatura"

